



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 40 regjistër (JR)

Datë 18.12.2018

Nr. 4 i vendimit

Datë 12.03.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian Hajdari	Kryesues
Luan Daci	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 12.03.2020, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatin, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e juridiksionit të rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 63, datë 06.08.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2, F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri”), i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 63, datë 06.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe avokatin Viktor Gumi, të cilët kërkuan përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Luan Daci, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Apelit Shkodër (në vijim “PPGjASh”) dhe i është nënshtuar procesit të rivlerësimit në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon se të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

1.1. Procesi i rivlerësimit për këtë subjekt rivlerësimi, është zhvilluar me përparësi nga Komisioni, duke qenë se ai ishte kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”), në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim “ligji nr. 115/2016”).

2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pas kryerjes së procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj¹, ka konkluduar se:

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), pas kryerjes së kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj, ishte i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës².

4. Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj³.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Me vendimin nr. 63, datë 06.08.2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj”.

6. Sipas rezultatit përfundimtar të Komisionit në lidhje me vlerësimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj kishte arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke arsyetuar se:

¹ Shih raportin nr. {***} prot., datë 09.11.2017, të ILDKPKI-së.

² Shih raportin nr. {***} prot., datë 30.10.2017, të DSIK-së, të deklasifikuar me vendimin nr. {***}, datë 30.01.2018, të KDZh-së.

³ Shih raportin nr. {***} prot., datë 12.12.2017, të Prokurorisë së Përgjithshme.

- a) kishte pasaktësi në deklarin e pasurisë;
- b) kishte burime financiare të ligjshme, dhe balancat financiare ndër vite, përkatësisht - 36013 lekë në vitin 2006 dhe -72779 lekë në vitin 2007, por se ishin të papërfillshme në lidhje me intensitetin e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera në këto vite;
- c) nuk kishte kryer fshehje pasurie, nuk kishte kryer deklarim të rremë dhe nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.

7. Për apartamentin e banimit në Bajram Curri⁴, Komisioni vlerësoi se privatizimi i banesave shtetërore është kryer në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” (në vijim “ligji nr. 7652/1992”), me anë të kontratës së shitjes, datë 05.10.1993, nga ku subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj rezultonte bashkëpronar në 1/5-tën pjesë takuese dhe nuk kishte dyshime mbi bashkëpronësinë dhe pjesën takuese në këtë bashkëpronësi. Përputhej, sipas Komisionit, deklarimi i subjektit të rivlerësimit me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.
8. Për shtëpinë e banimit në rrugën “{***}”, Tiranë,⁵ sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj kishte deklaruar burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.03.2011, për ½ e sipërfaqes së ndërtimit, prej 113 m², dhe të sipërfaqes së truallit prej 157 m², me vlerë 9.000.000 lekë, konkretisht, sipas Komisionit, kati përdhe i shtëpisë dykatëshe dhe sipërfaqja e truallit prej 78,5 m².

8.1. Në lidhje me deklarin, sipas Komisionit, në deklaratën *vetting* ku është deklaruar shtëpia e banimit me sipërfaqe ndërtimi 113 m², e fituar nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.03.2011, për çmimin 9.000.000 lekë, shtesa e katit në objektin ekzistues në këtë pasuri nuk ishte deklaruar, por sipas Komisionit, në dokumentacionin që kishte depozituar subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, dhe që shoqëronte deklaratën *vetting*, rezultonte e dorëzuar leja e legalizimit nr. {***}, datë 11.07.2012, çka do të thoshte për Komisionin se subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj e konsideron shtesën e katit si të përfshirë në deklarim në deklaratën *vetting*, si pjesë përbërëse të shtëpisë së banimit. Po sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit dispononte mjete të mjaftueshme financiare për ndërtimin e shtesës në katin e tretë, në shumën prej 1.700.000 lekësh.

8.2. Në përfundim, Komisioni çmoi se veprimet apo mosveprimet e subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj nuk mund të konsideroheshin sjellje aktive, me qëllim fshehje të pasurisë, e për pasojë për të mbuluar apo fshehur burimin e ligjshëm të krijimit, vendndodhjen ose lëvizjen e të ardhurave që kishin shërbyer për krijimin e tyre. Sipas Komisionit, deklarinet e subjektit të rivlerësimit, të ballafaquara me provat e disponuara, të çonin në konkluzionin se në lidhje me mosdeklarin e shtesës së katit në deklaratën *vetting*, nuk kishte fshehje pasurie, mungesë burimesh financiare të ligjshme apo deklarim të rremë, por një pasaktësi në deklarim dhe, për rrjedhojë, për Komisionin, nuk mund të konkludohej për shkelje të ligjit që mund të çonte deri në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.

⁴ Sipas deklarin të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* - apartament banimi (i prindërve) në qytetin Bajram Curri, me sipërfaqe banimi 76 m², pronë e fituar në bazë të kontratës së privatizimit të datës 05.10.1993, me adresë në lagjen “{***}”, pall. {***}, hyrja {***}, ap. {***}, Bajram Curri, me vlerë 2.211.600 lekë, pjesë takuese 20%

⁵ Sipas deklarin të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* - shtëpi banimi, me sip. ndërtimi 113 m², e blerë sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.03.2011, me adresë në Njësinë nr. {***}, rr. “{***}”, {***}, nr. {***}, Tiranë, me vlerë 9.000.000 lekë, pjesë takuese 20 %.

9. Për shtëpinë e banimit në fshatin {***}, Tropojë⁶, sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj kishte pasur të ardhura të mjaftueshme financiare, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës për kryerjen e bashkinvestimit, sipas aktmarrëveshjes për bashkinvestim për rikonstruksionin dhe bashkëpronësi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013, të deklaruar në deklaratën *vetting*.

9.1. Për personin e lidhur, znj. F.D., Komisioni konstatoi se ajo nuk kishte deklaruar në deklaratën *vetting*⁷ dy vlerat e tjera të blerjes së dy trojeve, përkatësisht:

a) 145.552 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.11.2008; dhe

b) 324.065 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.04.2011.

9.2. Komisioni ka vlerësuar se znj. F.D. i ka deklaruar këto dy pasuri në deklaratën *vetting*, së bashku me dy kontratat respektive me të dhëna të sakta identifikuese, numër repertori, numër koleksioni dhe datë përkatëse, të cilat kanë të përcaktuara si elemente të tyre edhe çmimin përkatës dhe, për rrjedhojë, për Komisionin, kjo ishte një mangësi e karakterit material⁸, por jo një shkelje e ligjit që mund të çonte deri në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.

9.3. Në lidhje me pagesat e kryera nga znj. F.D. për blerjen e objektit në fshatin {***}, Tropojë, Komisioni ka konstatuar se ato ishin kryer nga z. Sh.D., që për Komisionin kishte pasur mundësitë financiare për kryerjen e këtij shpenzimi. Ky fakt, sipas Komisionit, përforcohet po të konsideroheshin edhe të ardhurat e znj. F.D. në shumën 1.286.270 lekë për periudhën 2000 - 2011, sikurse Komisionit i rezultonte nga vërtetimi nr. {***} prot., datë 21.10.2016, i Degës së Sigurimeve Shoqërore Tropojë (në vijim "DRSSH T"), si dhe nga përgjigjet në pyetësor të subjektit të rivlerësimit, ku deklaronte se këto shuma monetare ishin të vogla dhe se mbuloheshin edhe nga kursimet e tij në vitet respektive.

9.4. Në përfundim, Komisioni çmoi se në kushtet që subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj e kishte deklaruar në vitin 2013 aktmarrëveshjen për bashkinvestim, si dhe burimin e krijimit të pasurisë dhe të bashkinvestimit në të, ai rezultonte me të ardhura të ligjshme dhe deklarimi në deklaratën *vetting* i godinës, trullit nën objekt dhe trullit funksional, pavarësisht mungesës së pasqyrimit të vlerës së dy trojeve, nuk sillnin pasoja për fshehje pasurie dhe nuk çonin në lindjen e dyshimeve mbi ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura.

10. Për gjendjet e llogarive përkatësisht në {***}, në shumën 972.000 lekë⁹, dhe në {***}, në shumën 9.400 euro¹⁰, Komisioni ka çmuar se përputhej deklarimi i subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj, me dokumentacionin e dorëzuar, me përgjigjet e ardhura nga {***} dhe {***}-ja, dhe se nuk kishte dyshime mbi këtë llogari. Komisioni, ka konstatuar gjithashtu se nuk kishte automjete në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të.

⁶ Nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, rezultonte një shtëpi banimi në fshatin {***} /Tropojë, sipas kontratës akt marrëveshje për bashkinvestim (për rikonstruksionin) dhe bashkëpronësi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013, vlera 5.000.000 lekë (vlerë jopërfundimtare), ku nuk ishin specifikuar përqindjet.

⁷ Nga deklarimi i personit të lidhur znj. F.D. në deklaratën *vetting*, rezultonte një shtëpi banimi në fshatin {***} /Tropojë sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2007, kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.11.2008, kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.04.2011. Me vlerë 700.000 lekë, e pjesë takuese 100%.

⁸ Mosshënimi i çmimit të blerjes.

⁹ Sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* - gjendje në llogari bankare, pranë {***}, vlera 972.000 lekë, pjesa 100%.

¹⁰ Sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* - gjendje në llogari bankare pranë {***}, vlera 9.400 euro, pjesa takuese 100%.

11. Gjithashtu, Komisioni, në drejtim të kontrollit të pasurive të subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj dhe të personave të lidhur me të, ka konstatuar se:

11.1. Nuk kishte dyshime në lidhje me kredinë e marrë në datën 18.05.2011 nga {***}-ja, në vlerën 5.000.000 lekë, me afat 180 muaj, me interes 4% në muaj, këste mujore 37.200 lekë, dhe shumë të detyrimit financiar që ka mbetur i pashlyer deri në fillim të procesit të rivlerësimit 3.504.087 lekë.

11.2. Nuk kishte dyshime mbi likuidimin e detyrimeve që buronin nga kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013, për rikonstruksionin e një shtëpie në fshatin {***}, ku nuk kishin përfunduar akoma punimet, në bazë të së cilës shuma e detyrimit financiar që kishte mbetur e pashlyer deri në fillim të procesit të rivlerësimit, ishte 2.550.000 lekë.

11.3. Nuk kishte aktivitete fitimprurëse në emër të subjektit të rivlerësimit apo të personave të lidhur me të.

11.4. Në lidhje me dhuratat në para *cash*, sipas Komisionit, për arsye se 5 prej tyre ishin transferuar nëpërmjet institucioneve jobankare, të marrëdhënieve shumë të ngushta familjare të dhuruesve dhe pranuesit të dhurimit¹¹, të deklaratave të personave dhurues, të deklaramit të këtyre shumave në deklaratat përkatëse periodike, nuk ka indicie apo edhe prova që këto dhurata të ishin produkt i ndonjë veprimtarie korruptive apo kriminale nga ana e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, sipas Komisionit, duke qenë se këto dhurata ishin deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklarimet periodike¹² të pasurisë, këto të fundit në bazë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të shërbejnë si provë për të krijuar bindjen se të ardhurat e dhuruesve nuk ishin në atë nivel që të çonin në lindjen e dyshimeve për të ardhura të pajustificuara.

12. Për sa i përket kontrollit të figurës, pas hetimit administrativ, nga Komisioni nuk u gjet asnjë element që të vërtetonte ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe, sipas Komisionit, referuar Aneksit të Kushtetutës, nenit Dh, dhe ligjit nr. 84/2016, kreu V, subjekti i rivlerësimit kishte rezultuar të ishte i përshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.
13. Për sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale, pas rekomandimit të relatorit të çështjes, Komisioni, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, e ka vlerësuar “të aftë”, pasi kishte treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, kishte respektuar të drejtat e palëve ose të viktimave dhe ishte eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

III. Shkaqet e ankimit

14. Komisioneri, nëpërmjet ankimit nr. {***} prot., datë 20.11.2018, kundër vendimit nr. 63, datë 06.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pretendoi se hetimi për kriterin e

¹¹ Vëlla, motër, mbesë dhe vjehërr.

¹² Në deklaratën periodike 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar 4.000 USD dhuratë cash nga motrat, znj. V.T., znj. N.S., znj. V.D., znj. D.N., gjatë vizitës së subjektit në ShBA në dhjetor 2006 - janar 2007, për blerjen e një autoveture. Në deklaratën periodike 2007, ka deklaruar 3.000 USD, dhuratë cash nga motra, znj. D.N., në nëntor 2007. Në deklaratën periodike 2009, ka deklaruar 300 USD, dërguar me {***} nga kunati, z. H.S. Në deklaratën periodike 2009, ka deklaruar 500 USD, dërguar me {***} nga znj. N.R. Në deklaratën periodike 2010, ka deklaruar 600 USD, dërguar me {***} në datën 11.01.2010 nga motra, znj. N.R. e cila jeton në ShBA, Nju Xhersi. Në deklaratën periodike 2013, ka deklaruar 2.000 USD, dërguar nga vajza e motrës, znj. E.T., me {***}, datë 07.06.2013, nga Nju Jorku, ShBA. Në deklaratën periodike 2013, ka deklaruar 200 euro, nga vjehërrin, z. Q.G., me banim në Vlorë, me {***}, datë 29.06.2013. Në deklaratën periodike 2015, ka deklaruar 500 USD, dërguar me {***} nga znj. N.R., datë 01.07.2015.

vlerësimit të pasurisë nuk kishte qenë i plotë dhe në gjendjen që ndodheshin aktet në dosje, sipas Komisionerit, nuk mund të arrihej në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj ndodhej në kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

15. Për shtëpinë e banimit në rrugën “{***}”, Tiranë, Komisioneri, nëpërmjet ankimit nr. {***} prot., datë 20.11.2018, pretendoi se hetimi i kryer nga Komisioni ishte i mangët në lidhje me:
 - a) huan në shumën prej 25000 USD nga kunati, z. H.S.¹³;
 - b) kredinë për shumën 5000000 lekë nga {***}-ja¹⁴;
 - c) moscilësimin e z. Sh.D. si person tjetër i lidhur¹⁵;
 - ç) mospërputhjen e pjesëve takuese¹⁶; si dhe
 - d) ekzistencën e konfliktit të interesit me z. S.D., duke kërkuar edhe verifikimin e rekordeve eventuale të këtij të fundit.
16. Për shtëpinë e banimit në fshatin {***} , Tropojë, Komisioneri, nëpërmjet ankimit nr. {***} prot., datë 20.11.2018, pretendoi se hetimi i kryer nga Komisioni ishte i mangët në lidhje me:
 - a) moscilësimin si person tjetër të lidhur të z. Sh.D.¹⁷;
 - b) funksionin e përdorimit të ndërtesës¹⁸;
 - c) moscilësimin si person tjetër të lidhur të znj. N.D.;¹⁹ si dhe
 - ç) shpenzimet e tjera për godinën.
17. Për dhuratat nga të afërmit, motrat, mbesa, kunati dhe vjehri, Komisioneri, nëpërmjet ankimit nr. {***} prot., datë 20.11.2018, pretendoi se hetimi i kryer nga Komisioni ishte i mangët në lidhje me verifikimin e burimit të ligjshëm dhe të pagesës së detyrimeve tatimore për vlerat monetare të dhuruara ndër vite.
18. Për sa i përket analizës financiare në Komision, për pjesën që u përket të ardhurave, shpenzimeve dhe kursimeve, Komisioneri, nëpërmjet ankimit nr. {***} prot., datë 20.11.2018, pretendoi se përfundimet që do të arriheshin në lidhje me klasifikimin e personave të tjerë të lidhur, hetimin e burimit të ligjshëm dhe pagesën e detyrimeve tatimore nga këta të fundit, do të ndikonin detyrimisht në analizën e përgjithshme financiare të subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj.

¹³ Sipas Komisionerit, nuk ishte kualifikuar si person tjetër i lidhur z. H.S., me pasojë mosjustifikimin e ligjshmërisë së burimit dhe nuk janë administruar shpjegimet, të dhënat dhe eventualisht rekordet e këtij personi.

¹⁴ Sipas Komisionerit, huaja ishte marrë duke bërë veprime fiktive, pasi nuk rezultonte të ishte hetuar nëse përfshihej në rrethin e personave përfitues sipas VKM-së nr. 600/2007.

¹⁵ Komisioneri ka renditur si rrethana - aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013 - dokumentacionin e ZVRPP Tiranë - përdorimin e automjetit me targë {***} në pronësi të këtij të fundit - përgjigjen e datës 17.07.2017 para Komisionit, sipas së cilës ka deklaruar se prej vitit 2004 ai dhe familja e tij kanë jetuar pa qira në banesën e blerë në vitin 2004 nga vëllai i tij - deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.11.2006.

¹⁶ Komisioneri rendit si rrethana se në deklaratën vetting pjesa takuese është deklaruar 20%, ndërkohë që në deklaratat periodike të viteve 2007 dhe 2011 pjesa takuese është deklaruar 100%, kishte diferencë në sipërfaqet e ndërtimit, si dhe paqartësi në numrin e kateve.

¹⁷ Komisioneri rendit si rrethana, aktmarrëveshje (bashkinvestim në fshatin {***}) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013 - sipas ZVRPP Tiranë janë bashkëpronarë - sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit ai ka përdorur automjetin {***} në pronësi të z. Sh.D..

¹⁸ Komisioneri i referohet shkresës nr. {***} prot., datë 06.02.2018 të OSHEE-së, rezulton se z. Sh.D. ka kontratë furnizimi nr. {***}, si konsumator jofamiljar (biznes) nga QKB, NUIS {***}, rezulton se ndërtesa është me fushë veprimtarie strukturë hotelerie “dhoma për fjetje bujtinë”, njëkohësisht edhe nga burime të hapura të informimit, ndërkohë që në përgjigje të pyetësorit 3, shprehet “duke qenë se nëna ka vendlindjen në fshatin {***} dhe pikërisht ku ndodhet objekti ish-shtetëror i privatizuar, kanë qenë tokë e familjes së saj të origjinës, ka vendosur për të blerë objektin për ta pasur si shtëpi për të gjithë fëmijët e saj”, argument të cilit i qëndron edhe në pretendimet përfundimtare.

¹⁹ Komisioneri rendit si rrethana, aktmarrëveshjen (bashkinvestitor) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013, se në vitin 2003 rezulton të jetë pjesë e certifikatës familjare - kontrata e furnizimit me energji nga OSHEE-ja nr. {***}, për banesën në rr. “{***}”, është lidhur në emër të znj. N.D.

19. Njëpërmjet parashtrimeve të datës 16.12.2019, Komisioneri, mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, kërkoi nga Kolegji çeljen e hetimit dhe marrjen e provave, me qëllim për të plotësuar mangësitë e procedurës para Komisionit.
20. Gjithashtu, në seancat gjyqësore publike të datës 04.12.2019 dhe të datës 16.12.2019, në përgjigje të pretendimeve të Komisionerit, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj, pasi kundërshtoi pretendimet e Komisionerit, kërkoi dhe ai nga Kolegji çeljen e hetimit gjyqësor, me qëllim për të administruar prova të reja.
21. Për shtëpinë në rrugën “{***}”, {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj, në kundërshtim me Komisionerin, pretendoi se justifikonte nga burime të ligjshme shumë prej 25.000 USD, hua nga kunati, z. H.S., se nuk kishte kryer veprime fiktive në përfitimin e kredisë për shumë 5.000.000 lekë nga {***}-ja, se nuk ishin kushtet për cilësimin si person tjetër të lidhur të vëllait, z. Sh.D., se nuk kishte mospërputhje në deklaram për pjesët takuese për këtë pasuri, si dhe se nuk ekzistonte situata e konfliktit të interesave me z. S.D.

21.1. Për shumë prej 25.000 USD, hua nga z. H.S., subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj pretendoi se kunati i tij, i cili kishte emigruar në ShBA në vitin 1995, së bashku me motrën e tij, znj. N.R., atje ishte biznesmen i suksesshëm në fushën e ndërtimit dhe të pasurive të paluajtshme, dhe se për z. H.S. atje kishte edhe shkrime të mediave të ndryshme. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit renditi shkrimin në gazetën “{***}” të datës 01.07.2014, *website* të ndryshme²⁰, interesat që ata kanë në disa shoqëri ndërtuese²¹, ekstraktin tregtar të shoqërisë {***}²², informacionin individual për të ardhurat vjetore për vitin 2018 të z. H.S. dhe znj. N.D., marrëveshjen përmbyllëse për kontratën e huas ndërmjet “{***}” dhe “{***}” për shumë 1.100.000 USD dhe letrën e angazhimit no. {***}, datë 29.05.2009, deklaratën e shlyerjes së vitit 02.05.2010 në vlerën 450.000 USD, formularin e deklaratës së të ardhurave të ortakërisë për vitin 2018 me total asetesh 3.582.129 USD, si dhe pasqyrën financiare të Bankës “{***}” për periudhën 08.01.2014 - 29.08.2014, me gjendje 2.164.254,83 USD. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, transaksioni ishte bërë nëpërmjet një banke kombëtare, një nga bankat më të mëdha në ShBA, që garantonte ligjshmërinë dhe burimin e transaksionit, dhe ky fakt, i ditur botërisht sipas subjektit të rivlerësimit, duhet të prezumohet si i tillë²³.

21.2. Për përfitimin e kredisë në shumë 5.000.000 lekë, me kushte lehtësuese nga {***}-ja, subjekti i rivlerësimit pretendoi se referencës ligjore, të cilës i referohet Komisioneri, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 12.09.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë” (në vijim

²⁰https://www.ingurier.com/philly/news/local/20081127_A_small_renaissance_in_W_Phika.html;
<https://openwes.com/9201d5c14c314cd98903e7d28314fe14>; <https://wnep.com/2017/05/21/new-life-for-an-old-school-in-wilkes-bare/>;

²¹ Shoqëritë: {***} - {***} - {***} dhe - {***}.

²² Subjekti i rivlerësimit referohet edhe në letrën e angazhimit no. {***}, datë 29.05.2009, si dhe në dokumentin shoqëruar të {***}, nr. i dosjes {***}.

²³ Konkretisht, sipas subjektit të rivlerësimit, *The Bank Secrecy Act* i vitit 1970 (BSA), i njohur ndryshe si akti i raportimit të transaksioneve në valutë dhe jashtë vendit, është ligji që detyron institucionet financiare që të njoftojnë agjencitë qeveritare për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave, dhe se ky ligj detyron çdo institucion financiar të mbajë të dhëna identifikuese të klientëve, si dhe informacion mbi burimet e parave dhe t'i raportojë ato për çdo transaksion bankar që i kalon 5.000,00 USD, dhe gjithashtu ky ligj i detyron institucionet financiare të raportojnë aktivitetet e dyshimta, që nënkupton pastrimin e parave, evazionin fiskal ose aktivitetet e tjera. Subjekti i rivlerësimit vijon se BSA është ligji parësor kundër pastrimit të parave në ShBA, dhe është ndryshuar për të përfshirë në të disa dispozita të titullit III, Patriot Act, për të zbuluar, parandaluar dhe goditur rrjetet e financimit të terrorizmit, dhe për më tepër, sipas subjektit të rivlerësimit, rregullorja zbatuese për nenin 326 të Patriot Act kërkon që çdo bankë të miratojë një program identifikimi të klientit, si pjesë e programit të tij të pajtueshmërisë me BSA.

“vendimi i KM-së nr. 600/2007”), duhet t’i shtohet edhe ligji nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”²⁴ (në vijim “ligji nr. 8737/2001”), duke vijuar se në mbështetje të parashikimeve ligjore të cituara më lart, ishte miratuar urdhri i kryeministrit nr. 122, datë 04.06.2010, “Për miratimin e numrit të përfituesve të kredive për strehim, sipas ministrive dhe institucioneve qendrore” (në vijim “urdhri i kryeministrit nr. 122/2010”), nëpërmjet të cilit ishte parashikuar një fond kredi prej 10 kuotash për prokurorinë shqiptare. Sipas subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj, duke qenë se ai në atë periudhë ishte në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, ai i plotësonte kriteret për të marrë kredi. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit parashtroi se familja e tij, në momentin e aplikimit ka qenë e përbërë nga 5 anëtarë, ku asnjë nga pjesëtarët e familjes nuk kishte pasur pasuri të paluajtshme për veprimtari biznesi, nuk kishte ushtruar veprimtari ekonomike, nuk kishte pasur mjete motorrike në pronësi, nuk kishte marrë asnjëherë nga shteti kredi të ngjashme dhe nuk kishte pasur kontrata të përkohshme apo të përhershme për blerje pasurie. Po sipas subjektit të rivlerësimit, në shtesën e katit, e cila ishte në procedurën e legalizimit, ishin kryer vetëm punimet, si: bërja e soletës, muret rrethuese të jashtme dhe hedhja e çatisë dhe ajo ka qenë e papërfunduar, karabina dhe e pabanueshme, dhe se kishte pritur marrjen e lejes ose legalizimin e ndërtimit, që u bë në korrik të vitit 2012, si dhe përfundimin e kësaj shtese, pasi duhej një vlerë e konsiderueshme monetare, që në atë periudhë nuk e dispononte të plotë.

21.3. Për cilësimin person tjetër të lidhur të vëllait të tij, z. Sh.D., subjekti i rivlerësimit parashtroi se nuk ishin marrëdhënie interesi, pasi nuk kishte asnjë marrëdhënie biznesi, por se ato ishin marrëdhënie ndihme familjare. Sipas subjektit të rivlerësimit, vëllai i tij, z. Sh.D., ka pasur një situatë shumë të mirë ekonomike dhe e ka ndihmuar dhe e ka mbështetur atë, sikurse e kanë mbështetur edhe motrat, dhe familja në tërësi²⁵. Në mbështetje të pretendimeve për të ardhurat e z. Sh.D., subjekti i rivlerësimit renditi ushtrimin e aktivitetit të tregtisë që në vitin 1994 deri në vitin 2002, shitjen e pjesëve të këmbimit dhe baterive për automjete²⁶, përfitimin, nëpërmjet {***}, New York, ShBA, në datën 27.07.2007, të një transferte bankare prej 299.000 USD nga z. H.S.²⁷, si dhe aktivitetin privat, dhoma për fjetje, bujtinë, sezonale, verore, nga viti 2016.

21.4. Për sa i përket pretendimit të Komisionerit për pjesën takuese në shtëpinë në rrugën “{***}”, {***}, Tiranë, të deklaruar 100%, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj parashtroi se ajo nuk ishte për shkak të ndarjes së pasurisë nga familja e tij, por për të identifikuar shpenzimet në vitin përkatës²⁸, ndërsa për diferencat në sipërfaqen e ndërtimit që rezultojnë

²⁴ Neni 47 i ligjit nr. 8737/2001, përcakton se: “1. Prokurori ka të drejtë të përfitojë banesë me kredi me kushte lehtësuese kur nuk ka banesë ose sipërfaqe të banueshme në rrethin ku punon. 2. Në rast se prokurori ka banesë në një rreth tjetër nga ai ku ushtron detyrën, ai përfiton sipas pikës 1 të këtij neni, por shuma e kredisë do të jetë sa diferenca ndërmjet vlerës së kredisë për banesën e re me vlerën e banesës që ka në pronësi. 3. Fondet për strehim parashikohen në buxhetin vjetor të Prokurorisë”.

²⁵ Subjekti i rivlerësimit shpjegon se vëllai i tij, motrat apo ndonjë pjesëtar i familjes së tij nuk ka qenë asnjëherë i përfshirë në ndonjë veprimtari të kundërligjshme të çfarëdo lloji natyre, dhe po kështu subjekti i rivlerësimit garanton se pasuritë që ata zotërojnë, janë të ligjshme dhe në këtë kontekst ishte i hapur për çfarëdo lloji hetimi.

²⁶ Sipas certifikatës së regjistrimit në organin tatimor nr. {***} e DRT Tropojë, si dhe pagimin e taksave për vitin 1994, në vlerën 4.500 lekë.

²⁷ Sipas SWIFT-it më datë 30.07.2007, është kredituar llogaria me një transfertë prej 299.950 USD, sipas SWIFT-it me dërgues R.D., H.S., {***} për Sh.D. me informacion, përshkrim “Loan Return”.

²⁸ Subjekti i rivlerësimit shpjegon se, duke qenë se familja e tij përbëhet edhe nga 4 anëtarë të tjerë, ka llogaritur pjesët takuese nga 20%, kjo referuar sipas tij certifikatës fundore të familjes, duke vijuar se kjo është ndarje e supozuar nga ana e tij, pasi, në bazë të K.Civil, nenit 231 dhe K.Familjes, neneve 73, 64 dhe 76, pjesët takuese, për familjen e tij, me 3 anëtarë madhorë, ndahen me nga 1/3 secili, por megjithatë, vlerëson se ky element nuk ndikon në burimin dhe ligjshmërinë e pasurisë.

nga kartelat e pasurisë së paluajtshme, në krahasim me sipërfaqet e titujve të pronësisë, subjekti i rivlerësimit parashtroi se nuk ishte në gjendje të jepte një shpjegim, pasi nga ana e Komisionerit nuk ishte specifikuar se si ishte kjo diferencë, por se mendonte se kishte të bënte me sipërfaqen e kafazit të shkallëve për shtesën e katit të tretë.

21.5. Për pretendimin e Komisionerit mbi ekzistencën e konfliktit të interesit me z. S.D., subjekti i rivlerësimit parashtroi se nuk e njihte dhe se nuk e kishte takuar asnjëherë. Sipas subjektit të rivlerësimit, vëllai i tij, z. Sh.D., e ka blerë shtëpinë në rrugën “{***}”, Tiranë, rreth 30% më shtrenjtë, duke qenë se sipas tij çmimi i blerjes ishte 3.900.000 lekë. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit renditi kontratën e shitblerjes të datës 17.11.1992, ndërmjet Këshillit të Rrethit Tiranë dhe z. A.L., për vlerën 31.104 lekë, kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.01.1993, ndërmjet z. A.L. dhe z. B.K., për vlerën 310.000 lekë, kontratën e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.07.1993, ndërmjet z. B.K. dhe z. S.D., dhe kontratën nr. {***}, datë 09.09.1993, me firmën “{***}”, për ndërtimin e shtëpisë në vlerën 24.000 USD (2370.000 lekë)²⁹. Sipas subjektit të rivlerësimit, akti i kolaudimit nuk ishte në përputhje me realitetin, pasi në atë kohë nuk kishte një akt normativ, sikurse vendim të KM-së, ku të ishte përcaktuar kostoja e ndërtimit, dhe sipas analizimit që ai vetë ka bërë, kostoja e ndërtimit rezultonte rreth 10.443 lekë³⁰ dhe, për këtë arsye, vlera mesatare e ndërtimit të objektit nuk mund të ketë qenë 5.600.000 lekë ose rreth 24.779 lekë/m². Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, edhe vetë akti i kolaudimit që nxjerr shifrën prej 5.600.000 lekësh, nga ana formale është me të meta të theksuara, duke referuar në pikën 5 të aktit të kolaudimit, ku thuhet se kontrata është zbatuar dhe janë respektuar çmimet e preventivit dhe projekti i miratuar, ndërkohë që në këtë kontratë dhe në asnjë dokument tjetër nuk ka çmime të preventivit.

22. Në lidhje me shtëpinë e subjektit të rivlerësimit në {***}, Tropojë, subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me pretendimet e Komisionerit, pretendoi se nuk ishin kushtet për cilësimin si person tjetër të lidhur të vëllait të tij, z. Sh.D., dhe theksoi funksionin e përdorimit të ndërtesës së deklaruar si “shtëpi banimi”, se nuk ishin kushtet për cilësimin si person tjetër të lidhur të motrës së tij, znj. N.D., ndërsa për përllogaritjen e shpenzimeve të tjera për godinën, në funksion të objektit të shfrytëzimit si strukturë hoteliere, ritheksoi se me vëllain e tij, z. Sh.D., nuk kishte asnjë marrëdhënie interesi.

22.1. Për cilësimin person tjetër të lidhur të vëllait të tij, z. Sh.D., sikurse më lart, subjekti i rivlerësimit ritheksoi se ato janë marrëdhënie ndihme familjare, duke konfirmuar se në çdo kohë ai e ka ndihmuar dhe e ka mbështetur. Sipas subjektit të rivlerësimit, mundësitë financiare, sikurse 9.000.000 lekët e fituara nga shitja e një pjese të shtëpisë, si dhe transfertat bankare nga motra dhe kunati si bashkinvestues, e justifikojnë investimin e kryer për pjesën e investimit, të këtyre të fundit, në shtëpinë në fshatin {***}. Sipas subjektit të rivlerësimit, në vazhdim të investimit të kryer prej vëllait të tij, z. Sh.D., dhe motrës, znj. N.D., një pjesë e materialeve të ndërtimit, si: mbulesa e çatisë, veshja e jashtme e godinës, parketi dhe të tjera, ishin dërguar nga motra dhe kunati me kontejnerë nga ShBA-ja gjatë viteve 2014 dhe 2015, dhe po kështu ishin dërguar prej tyre pajisje arredimi, si: karrige, tavolina, mobilie druri, kolltukë, dyshekë, abazhurë, pajisje kuzhine dhe të tjera, me vlerë rreth 30.000 USD, duke referuar për këtë qëllim në praktikat e zhdoganimit.

²⁹ Subjekti i rivlerësimit shpjegon gjithashtu se tavani i katit të dytë të shtëpisë ka qenë i ndërtuar me kallamishte, gjë që nuk i ishte thënë vëllait të tij në momentin e blerjes dhe ky fakt nuk është i përshkruar në aktin e kolaudimit; shpenzimet për formalizimin e pronës ishin paguar nga vëllai i tij, sipas konfirmimit të avokatit B.B., që ka përfaqësuar z. S.D. në procesin gjyqësor në GjRrGjT.

³⁰ Referuar raportit të rivlerësimit nga E.L. për ndërtimin e kryer në vitet 1992 - 1997 me kosto ndërtimi rreth 10.443 lekë/m².

22.2. Për verifikimin e funksionit të përdorimit të ndërtesës së deklaruar si shtëpi banimi, subjekti i rivlerësimit parashtroi se objekti kishte përfunduar në pjesën e strukturës, si dhe pjesën që i takon vëllait, z. Sh.D., dhe motrës znj. N.D., ndërsa në pjesën anësore të tij ka një hyrje të veçantë pa komunikim me pjesën tjetër të objektit, ku është pjesa takuese e banimit të tij. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo pjesë e objektit është ende e papërfunduar, duke referuar për këtë qëllim në ekspertimin privat të kryer me kërkesën e tij, si dhe në deklaratat noteriale të z. Sh.D. dhe znj. N.D.³¹

22.3. Për cilësimin si person tjetër të lidhur të motrës së tij, znj. N.D., subjekti i rivlerësimit parashtroi se gjatë gjithë kohës motra e tij dhe bashkëshorti, z. H.S., e kanë ndihmuar atë, vëllain e tij Sh.D. dhe pjesëtarët e tjerë të familjes, në kuadrin e një ndihme familjare dhe pa asnjë qëllim interesi apo biznesi. Për sa i përket pasurisë së motrës së tij, znj. N.D., subjekti i rivlerësimit parashtroi se ishin të vlefshme arsyetimet e bëra për bashkëshortin e saj, z. H.S., duke theksuar se ajo ishte bashkëpronare me 50% të kapitalit të shoqërisë “{***}”. Për sa i përket verifikimit të policës së sigurimit apo kartonit jeshil të automjeteve me targë {***} dhe {***}, në pronësi të motrës së tij, znj. N.D., subjekti i rivlerësimit parashtroi se Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim “AMF”) kishte konfirmuar se subjekti i rivlerësimit nuk kishte qenë asnjëherë mbajtës i policës së sigurimit MTPL dhe i kartonit jeshil për këto automjete³².

22.4. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të tjera për godinën, në funksion të objektit të shfrytëzimit si strukturë hoteliere, subjekti i rivlerësimit theksoi sërish se nuk kishte asnjë marrëdhënie biznesi me vëllanë e tij, z. Sh.D.

22.5. Për pjesën takuese të tij, në objektin në {***}, Tropojë, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj referon në deklaratat vjetore të viteve 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018, të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, në të cilat pretendon se ka deklaruar të gjitha shpenzimet që ka kryer për pjesën e tij të investimit.

- 23.** Në kundërshtim me Komisionerin, për dhuratat në likuiditete nga të afërmit, përkatësisht 4000 USD dhuratë *cash* nga motrat, znj. V.T., znj. N.S., znj. V.D., znj. D.N.³³, 3000 USD dhuratë *cash* nga motra, znj. D.N.,³⁴ 300 USD, dërguar me {***} nga kunati, z. H.S., dhe 500 USD, dërguar me {***} nga znj. N.R.³⁵, 2000 USD, dërguar nga vajza e motrës, znj. E.T., me {***}, datë 07.06.2013, nga Nju Jorku dhe 200 Euro, nga vjehri, z. Q.G., me banim në Vlorë, me {***}, datë 29.06.2013³⁶, 500 USD, dërguar me {***} nga znj. N.R.³⁷, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj pretendoi se ato ishin të ardhura të ligjshme, pasi dhuruesit janë persona të rrethit të ngushtë familjar, dhe se në asnjë moment ata nuk kanë pasur asnjë interes të lidhur me funksionin e tij apo të bashkëshortes së tij.

23.1. Dhurimet e mësipërme, sipas subjektit të rivlerësimit, ishin në masën 2,6% të të ardhurave të tij dhe, si pasojë, ato përbënin një peshë specifike shumë të vogël që sipas parimit të proporcionalitetit, nuk ishin në atë nivel që të çonin në lindjen e dyshimeve për të

³¹ Subjekti i rivlerësimit shpjegon se në pjesën e tij takuese janë kryer punimet e vrazhda, si suvatimet, çatia etj., por nuk kanë përfunduar instalimet hidraulike, elektrike, shtrimet e dhomave etj., dhe se në lidhje me gjendjen e punimeve ka kërkuar vlerësimin nga një ekspert i licencuar, sipas aktit të ekspertimit të paraqitur në Kolegj, për gjendjen aktuale dhe vlerën e punimeve të pjesës së tij, prej 4.219.140 lekësh.

³² Subjekti i rivlerësimit referon në shkresën nr. {***} prot., datë 24.10.2019, të AMF-së.

³³ Gjatë vizitës së subjektit në ShBA në dhjetor 2006 - janar 2007, për blerjen e një autoveture, sipas deklaratës periodike 2006.

³⁴ Në nëntor 2007, sipas deklaratës periodike 2007.

³⁵ Sipas deklaratës periodike 2009.

³⁶ Sipas deklaratës periodike 2013.

³⁷ Datë 01.07.2015, sipas deklaratës periodike 2015.

ardhura të pajustificuara, ndërkohë që sipas subjektit të rivlerësimit, secili prej dhuruesve kishte mundësi financiare për të bërë dhurimin përkatës³⁸. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, dhurimet nuk janë të ardhura të tatueshme, sepse ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8438/1998”), nuk jep përkufizim specifik në lidhje me të ardhurat e krijuara nga dhuratat e familjarëve të ngushtë, sikurse as në udhëzimin nr. 5/2006 të ministrit të Financave nuk përmenden në mënyrë specifike.

24. Në lidhje me analizën financiare të të ardhurave, shpenzimeve dhe kursimeve, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj, në kundërshtim me Komisionerin, pretendoi se të ardhurat në shumën 45000 lekë, nga mësimdhënia pranë {***}³⁹, dhe pjesëmarrja në Këshillin e Prokurorisë në shumën 48000 lekë⁴⁰, huaja e kunatit, z. H.S., në shumën 25000 USD, dhuratat nga të afërmit, në shumën totale prej 10.300 USD dhe 200 Euro, plotësonin kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

24.1. Për të ardhurat⁴¹ nga {***}, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj paraqiti nxjerrjen e llogarisë nga {***}, ndërsa për të ardhurat nga Këshilli i Prokurorisë paraqiti vërtetimin e institucionit⁴².

25. Në lidhje me analizën e përgjithshme financiare, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj, në kundërshtim me Komisionerin, përkatësisht për vitin 2006 në vlerën -358058 lekë, për vitin 2007 në vlerën -810767 lekë, për vitin 2008 në vlerën -69860 lekë, për vitin 2011 në vlerën -2298509 lekë, dhe për vitin 2013 në vlerën -625951 lekë,⁴³ pretendoi se nuk ishin pasqyruar kursimet e deklaruara në vitet e mëparshme, nuk ishin llogaritur si të ardhura huaja dhe dhurimet, si dhe që shpenzimet e udhëtimit ishin përlllogaritur si shpenzime të veçanta, kur në fakt sipas ILDKPKI-së dhe të dhënave të INSTAT-it, ato parashikohen në shpenzime jetike.

25.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, rezultatet negative të Komisionerit, janë si rrjedhojë kryesisht e mosmarrjes në konsideratë të të ardhurave, si huatë, dhuratat nga të afërmit. Gjithashtu, sipas tij, një ndikim me diferencë negative, edhe pse jo të rëndësishëm dhe përcaktues, kishte pasur edhe vlerësimi i disa zërave në analizën financiare të paraqitur në mënyrë jo të saktë nga Komisioneri, pasi kishte llogaritur më pak të ardhura, më shumë shpenzime dhe shtesa në likuiditete të llogaritura më shumë, si pasuri e shtuar.

26. Kolegji, pas kërkesës së Komisionerit dhe të subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj, me vendimin e ndërmjetëm, datë 16.12.2019, në funksion të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 45, pika 1 e ligjit nr. 86/2016, vendosi të riçelë hetimin gjyqësor, të lejojë marrjen e provave dhe të akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit⁴⁴, dhe të kërkojë dokumente nga institucionet shtetërore, me qëllim për të përcaktuar gjendjen e fakteve për këtë çështje.

³⁸ Subjekti i rivlerësimit shpjegon më tej se nga ILDKPKI-ja nuk janë hedhur dyshime në lidhje me ligjshmërinë e burimeve apo t'i jetë kërkuar ndonjë dokument justifikues në lidhje me dhuruesit.

³⁹ Sipas deklaratës periodike 2008.

⁴⁰ Sipas deklaratës periodike 2003.

⁴¹ Në lidhje me të ardhurat nga {***} dhe Këshilli i Prokurorisë, subjekti i rivlerësimit shpjegon se tatimi është mbajtur në burim nga institucionet përkatëse, dhe në këto kushte vlerëson se plotësohen kriteret për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme.

⁴² Vërtetimi nr. {***} prot., datë 18.03.2019, i Këshillit të Prokurorisë.

28.6.34. Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme¹³⁷ nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2007, shitës z. T.M., blerëse znj. F.D., për pasurinë sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor nr. {***}, datë 19.03.2007, si dhe H.T.R. (provizore) lëshuar nga ZVRPP Tropojë, pas. nr. {***}, zk {***}, sip. 88 m², me adresë fshati {***}, rrethi Tropojë, ndërtesë njëkatëshe me kallkane, trualli, pronë e shtetit, çmimi 700000 lekë.

28.6.35. Letërnjoftim¹³⁸ nr. {***} i znj. F.D.¹³⁹.

28.6.36. Kartela e pasurisë së paluajtshme, datë 23.12.2019, e ASHK Tropojë, zk {***}, nr. pas. {***}, vol. {***}, fq. {***}, adresa Tropojë, {***}, lloji i pasurisë “truall”, sip. totale 197 m², data e regjistrimit 22.06.1991, me pronare znj. F.D., shënime “kontratë shitje”.

28.6.37. Inventar i dosjes, datë 23.01.2008, i ASHK Tropojë¹⁴⁰.

28.6.38. Kërkesë, datë 23.01.2008, e znj. F.D. drejtuar ZVRPP Tropojë, për certifikatën e pas. nr. zk {***}, nr. pas. {***}, {***}, tipi i dokumentit “kalim pronësie”, datë e dokumentit përgatitur nga noteri 07.01.2008, data e paraqitjes 23.01.2008.

28.6.39. Shkresa nr. {***} prot., datë 07.01.2007, e DASHPP-së drejtuar ZVRPP-së Tropojë¹⁴¹.

28.6.40. Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.11.2008, me shitës DASHPP, z. T.M., blerëse znj. F.D., me objekt shitjen e truallit të objektit mensë/kuzhinë, {***}, Tropojë, sip. 88 m², nga e cila në objekt 88 m², me çmimin 145552 lekë.

28.6.41. Autorizimi nr. {***} prot., datë 27.11.2007, i DASHPP-së, drejtuar znj. F.D., Komunës Margegaj, ZVRPP Tropojë, me lëndë “autorizim për pagese trualli”¹⁴².

28.6.42. Veprim arke, datë 03.12.2007, i {***}, udhëzime operative, znj. F.D. arkëtonte për DASHPP-në, për shitje trualli, me përshkrimin: “Derdhje cash 145702,00 lekë”.

28.6.43. Shkresa nr. {***} prot., datë 23.11.2007, e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim “AKKP”), drejtuar Ministrisë së Financave, DASHPP-së, me lëndë “kthim përgjigjeje”¹⁴³.

¹³⁷ Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2007, rezulton të jetë e përsëritur në kthim përgjigjen nr. {***} prot., datë 30.12.2019, e ASHK Tropojë.

¹³⁸ Letërnjoftim nr. {***}, i znj. F.D., rezulton të jetë i përsëritur në kthim përgjigjen nr. {***} prot., datë 30.12.2019, të A.Sh.K. Tropojë.

¹³⁹ Datë lëshimi 04.05.1981.

¹⁴⁰ Dokumentet: 1). fletë inventari; 3). data 23.01.08, aplikim për kalim prone + V.P. + H.T.R.; 95). data 07.01.07, shkresë nga M.Fin. subjekti kon. shit. truall; {***}). kontratë shitjeje me notere D.P. Tiranë; {***}). data 27.11.2007, autorizim për pagesë trualli M.Fin.; v). mandatar-këtim; {***}). data 23.11.2007, Min. Fin. Kthim përgjigje nga AKKP; data 31.05.07, H.T.R.; plan vendosje; Gen plan; {***}). data 04.05.1981, foto pasp.; data 23.01.08, vërtetim prone; H.T.R.

¹⁴¹ Me shënimin: “Dërgojmë kontratë shitjeje objekti dhe trualli të privatizuar, nga ku rezulton se dërgohet një kopje në origjinal e kontratës së shitjes së truallit të objektit mensë/kuzhinë {***}, Tropojë, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.01.2008”.

¹⁴² Nga ku rezulton se DASHPP-ja autorizonte shitjen e truallit me sip. prej 88 m² të objektit mensë/kuzhinë, {***}, Tropojë, ish-pronë e Ndërmarrjes Gjeologjike Tropojë, në pronësi private të znj. F.D., dhe se në bazë të kontratës së shitjes së objektit nr. {***} rep., datë 27.12.1991, kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2007, si dhe në bazë të shkresës së dërguar nga Komuna Margegaj, Tropojë me nr. {***}, datë 30.06.2007, është 88 m², çmimi i shitjes është 1.654 lekë/m², vlera e shitjes së kësaj sip. është 145.552 lekë.

¹⁴³ Nga ku rezulton se objekti i sipërpërmendur, mensë/kuzhinë, {***}, objekt i ish-Ndërmarrjes Gjeologjike Tropojë, sipas kërkesës nr. {***}, datë 23.05.2007, me sip. 88 m², është pronë e fituar nga qytetarja F.D., me kontratën nr. {***}, datë 27.03.2007, dhe hipotekuar po në këtë datë dhe ndodhet në fshatin {***} të Komunës Margegaj, mbështetur në hartën e vlerës për qarkun e Kukësit, të miratuar me vendimin e KM-së nr. 653, datë 29.09.2007, “Për miratimin e çmimeve të trojeve të përcaktuara në hartën përkatëse për qarqet e Lezhës, Dibërës, Korçës dhe Kukësit, çmimi i truallit është 1.645 lekë/m²”.

28.6.44. Harta treguese e regjistrimit, datë 31.05.2007, e ZVRPP Tropojë, zk {***}, nr. pas. {***}, vol. s'ka, f. s'ka, adresa: Tropojë, {***} ; me pronare znj. F.D.

28.6.45. Planvendosja e pasurisë nr. {***}, datë 11.05.2007, e Komunës Margegaj, objekt {***}, truall, fshati {***} , Komuna Margegaj, me pronare znj. F.D., sip. tr. 604.5 m², sip. 88 m².

28.6.46. Letërnjoftim¹⁴⁴ nr. {***} i znj. F.D.¹⁴⁵.

28.6.47. Vërtetim nga dokumentet hipotekore, datë 23.01.2008, i ZVRPP Tropojë, regjistri hipotekor nr. {***}, datë 23.01.2008, me pronare znj. F.D., pjesa individuale, pas. nr. {***}, zk {***}, sip. 88 m², adresa: {***} , Tropojë; trualli mbi të cilin është objekti mensë/kuzhinë, komente nga regjistruesi: “Pronë e fituar nga kontrata e shitjes nr. {***}, datë 07.01.2008, vlera 145552 lekë, redaktuar nga notere D.P.”.

28.6.48. Harta treguese e regjistrimit (provizore), datë 23.01.2008, e ZVRPP Tropojë, zk {***}, nr. pas. {***}, vol. s'ka, f. S'ka, adresa: Tropojë, {***} ; me pronare znj. F.D.

28.7. Shkresa nr. {***} prot., datë 08.01.2019, e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë (në vijim “PPGjShP”) Durrës, në përgjigje të shkresës nr. {***} prot., datë 18.12.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe të shkresës nr. {***} regj., datë 17.12.2019, të relatorit të çështjes¹⁴⁶.

28.8. Shkresa nr. {***} prot., datë 14.01.2020, e PPGjShP Tiranë, në përgjigje të shkresës nr. {***} prot., datë 18.12.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe shkresës nr. {***} regj., datë 17.12.2019, të relatorit të çështjes¹⁴⁷.

28.9. Shkresa nr. {***} prot., datë 17.01.2020, e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (në vijim “MTM”), në përgjigje të shkresës nr. {***} prot., datë 18.12.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe shkresës nr. {***} regj., datë 17.12.2019, të relatorit të çështjes.

28.10. Njëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, MTM-ja, vendosi në dispozicion praktikën nr. {***} prot., datë 31.12.2019, sipas kërkesës së paraqitur pranë MTM-së nga subjekti Sh.D. person fizik, me NIPT {***}, për t’u pajisur me certifikatë kategorizimi për strukturën akomoduese, bashkëlidhur¹⁴⁸ së cilës rezultojnë sa më poshtë.

¹⁴⁴ Letërnjoftim nr. {***}, i znj. F.D., rezulton të jetë i përsëritur në kthim përgjigjen nr. {***} prot., datë 30.12.2019, të ASHK Tropojë.

¹⁴⁵ Datë lëshimi 04.05.1981.

¹⁴⁶ Nga shkresa nr. {***} prot., datë 08.01.2019, e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me lëndë “kthim përgjigjeje”, në vijim të shkresës nr. {***} prot., datë 18.12.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe shkresës nr. {***} regj., datë 17.12.2019, të relatorit të çështjes, rezulton se P.Gj.Sh.P.D.-ja, pasi konstaton se, në vijim të kërkesës për informacion nr. {***} prot., datë 18.12.2019, ku kërkohet informacion nëse subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj ka trajtuar akte procedurale ose materiale të referuara nga organet ligjzbatuese në lidhje me z. S.D., në vijim P.Gj.Sh.P.D.-ja, bën me dije se, pas verifikimeve të kryera në sistemin elektronik në Zyrën e Regjistrimit, rezulton se Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës nuk ka të regjistruar procedim penal në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur, aktet procedurale ose materiale të të cilit janë trajtuar nga subjekti i rivlerësimit.

¹⁴⁷ Nga shkresa {***} prot., datë 14.01.2020, e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me lëndë “kthim përgjigjeje”, në vijim të shkresës nr. {***} prot., datë 18.12.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe shkresës nr. {***} regj., datë 17.12.2019, të relatorit të çështjes rezulton se Prokuroria Tiranë, në përgjigje të kërkesës nr. {***} prot., datë 18.12.2019, në të cilën kërkohet informacion për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, nga verifikimi i kryer në regjistrat e kallëzimeve dhe statistikën elektronike për periudhën kohore nëntor 2003 - maj 2008, periudhë në të cilën subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj ka qenë prokuror në Prokurorinë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk rezultoi që ky subjekt të ketë trajtuar akte procedurale ose materiale referimi në lidhje me shtetasin S.D.

¹⁴⁸ Dokumentet bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, janë fotokopje, të përsëritura, si dhe rezulton që të jetë përcjellë edhe kopje e ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”.

28.10.1. Shtojca nr. 2¹⁴⁹, nr. {***} prot., datë 31.12.2019, kërkesë për pajisje me certifikatë kategorizimi të strukturës akomoduese, për bujtinë, të subjektit aplikues Sh.D. person fizik, me përshkrim të veprimtarisë: “nga viti 2017 ushtrij aktivitetin e hotelerisë në Bujtinën {***} , këtë aktivitet e ushtrij vetëm në periudhën e verës, për rreth 5 muaj [...]”.

28.10.2. Shtojca nr. 3¹⁵⁰, formular vetëdeklarimi për aplikim për kategorizimin e strukturave akomoduese, kategoria për të cilën aplikon bujtinë, emri i subjektit Sh.D., NIPT {***}, kapaciteti akomodues në dhoma: 12 dhoma, kapaciteti akomodues në shtretër: 26 shtretër, kapaciteti në restorant: 28 vende, punonjës me kohë të pjesshme: 2 femra, punonjës me kontratë: 1, të vetëpunësuar: 1 femër dhe 1 mashkull, numri i kateve të strukturës akomoduese: 2 + 1, vende parkimi 10, ofrimi i vakteve të tjera: mëngjes dhe darkë.

28.10.3. Leje ndërtimi¹⁵¹ nr. s'ka prot., datë 05.03.2013, zhvilluesit, znj. F.D., për punimet, rikonstrukcion dhe shtesë kati, objekti 2 kate dhe papafingo, fshati {***} , komuna Margegaj, rrethi Tropojë, afati kohor i kësaj leje ishte deri në datën 05.03.2015.

28.10.4. Leje zhvillimi¹⁵² nr. s'ka prot., datë 05.03.2013, zhvilluesit, znj. F.D., për punimet, rikonstrukcion dhe shtesë kati, objekti 2 kate dhe papafingo, fshati {***} , komuna Margegaj, rrethi Tropojë, afati kohor i kësaj leje ishte deri në datën 05.03.2015.

28.10.5. Akt-miratim higjiëno-sanitar nr. {***}¹⁵³, datë 04.09.2018, i Inspektoratit Shtetëror Sanitar (në vijim “ISSh”), personit fizik Sh.D., me adresë në fshatin {***} , Tropojë, me aktivitet restorant, NIPT {***}, nga ku rezulton se pas ekspertimit higjiëno-sanitar të kryer nga ISSh-ja, i është dhënë akt-miratimi higjiëno-sanitar për vënien në shfrytëzim të objektit, me destinacionin “restorant”.

28.10.6. Akt-miratim higjiëno-sanitar nr. {***}¹⁵⁴, datë 04.09.2018, i IshS-së, personit fizik Sh.D., me adresë në fshatin {***} , Tropojë, me aktivitet hotel shtretër, NIPT {***}, nga ku rezulton se pas ekspertimit higjiëno-sanitar të kryer nga ISSh-ja, i është dhënë akt-miratimi higjiëno-sanitar për vënien në shfrytëzim të objektit, me destinacionin “hotel, 26 shtretër”.

28.10.7. Planimetria e strukturës akomoduese¹⁵⁵, arkitekt H.I.

28.10.8. Certifikatë regjistrimi¹⁵⁶ e QKR-së, datë regjistrimi 27.07.2016, datë lëshimi 25.11.2019, personit të tatueshëm Sh.D. person fizik, NIPT {***}, me status të pezulluar, me adresë kryesore: Kukës, Margegaj, Lagjja Qendër, {***} , rr. “{***}”, objekti nr. {***} zk {***}, nr. pas. {***}.

28.10.9. Ekstrakti historik¹⁵⁷, datë 25.11.2019, i QKR-së, i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit person fizik Sh.D., NIPT {***}.

¹⁴⁹ E përsëritur 2 herë në materialet bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

¹⁵⁰ E përsëritur 2 herë në materialet bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

¹⁵¹ E përsëritur 2 herë në materialet bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, e vërtetuar njësisë me origjinalin me veprimin noterial nr. {***} rep., datë 26.12.2019.

¹⁵² E përsëritur 2 herë në materialet bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, e vërtetuar njësisë me origjinalin me veprimin noterial nr. 7190 rep., datë 26.12.2019.

¹⁵³ E përsëritur 2 herë në materialet bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, e vërtetuar njësisë me origjinalin me veprimin noterial nr. {***} rep., datë 26.12.2019.

¹⁵⁴ E përsëritur 2 herë në materialet bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, e vërtetuar njësisë me origjinalin me veprimin noterial nr. {***} rep., datë 26.12.2019.

¹⁵⁵ E përsëritur 2 herë në materialet bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

¹⁵⁶ E përsëritur 2 herë në materialet bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

28.10.10. Foto¹⁵⁸ të brendshme dhe të jashtme, strukturat akomoduese dhe objekti.

28.10.11. Zarfi postar, datë 26.12.2019, me dërgues z. Sh.D. dhe marrës MTM-në.

28.10.12. Vërtetim i gjendjes gjyqësore¹⁵⁹ nr. {***} prot., datë 17.12.2019, i Ministrisë së Drejtësisë¹⁶⁰.

29. Sipas vendimit të ndërmjetëm, datë 16.12.2019, të Kolegjit, për të dhënë vlerësimin e tij në lidhje me denoncimet e publikut të regjistruara pas dhënies së vendimit, Komisioneri në seancën gjyqësore publike të datës 16.01.2020 dhe shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Institucionit të Komisionerëve Publikë (në vijim “IKP”) ka parashtruar sa më poshtë.

29.1. Në vijim të denoncimit të z. F.B.¹⁶¹, të dërguar në adresën zyrtare të postës elektronike të IKP-së në datën 16.08.2018, lidhur me pasurinë e subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj, Komisioneri evidentoi disa çështje, si:

- a) subjekti ka përfituar kredi si i pastrehë në kundërshtim me ligjin nr. 9232/2004¹⁶², si dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 600/2007 të Këshillit të Ministrave;
- b) ndërkohë që merrte kredi si i pastrehë, nuk ka deklaruar shtesën prej 123 m² të vilës në proces legalizimi, gjithashtu ka fshehur pronësinë e vilës në {***}, në emër të vëllait të tij;
- c) subjekti ka ndërtuar hotel luksoz në {***}; dhe
- c) ka lidhje me trafikantët ndërkombëtarë D.D. dhe D.K.

29.2. Në vijim të denoncimit të znj. B.A.¹⁶³, datë 30.08.2018, të dërguar me anë të postës elektronike pranë IKP-së, Komisioneri evidentoi:

- a) subjekti zotëron një vilë katërkatëshe në {***} të Tiranës, të cilën e ka fshehur në emër të vëllait dhe të motrave, duke u hequr vetë si i pastrehë dhe duke përfituar kredi të butë, në kundërshtim me ligjin, ka fshehur dhe legalizimin e vilës;
- b) ka ndërtuar hotel në {***}, një nga hotelet më luksoze të zonës, me 20 dhoma, të cilin e ka paraqitur si shtëpi pushimi; dhe
- c) Komisioni nuk ka kryer asnjë hetim për huat dhe dhuratat nga motrat, gjithashtu, dhe vëllai rezulton gjithë kohës i papunë dhe ka disa prona.

29.3. Në vijim të denoncimit të znj. B.U.¹⁶⁴, të dërguar me anë të postës elektronike pranë IKP-së në datën 05.11.2018, Komisioneri evidentoi:

- a) bazuar në këtë denoncim, rezulton se subjekti ka një vilë trekatëshe në mes të Tiranës dhe hotel në {***};

¹⁵⁷ E përsëritur 2 herë në materialet bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

¹⁵⁸ E përsëritur 2 herë në materialet bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

¹⁵⁹ E përsëritur 2 herë në materialet bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

¹⁶⁰ Sipas së cilës, nga verifikimet që iu bënë shënimeve në regjistrin gjyqësor, rezultonte se shtetasi Sh.D., i biri i M. dhe i F., lindur më 07.01.1958, në {***} Q. Tropojë Alb., ishte “i padënuar”.

¹⁶¹ Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i z. F.B. rezulton i regjistruar me nr. {***} prot., datë 23.08.2018.

¹⁶² Shfuqizuar me ligjin, nr.22/2018 “Për strehimin social”.

¹⁶³ Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP. për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i znj. B.A. rezulton i regjistruar me nr. {***} prot., datë 31.08.2018.

¹⁶⁴ Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i znj. B.U. rezulton i regjistruar me nr. {***} prot., datë 12.11.2018.

- b) Komisioni nuk ka hetuar me çfarë lekësh e bleu vilën në vitin 2004 vëllai i subjektit, marangoz nga Tropoja;
- c) në vitin 2006, subjekti ka ndërtuar katin e tretë pa leje, ndërtim të cilin nuk e ka deklaruar në deklaratën vjetore, dhe Komisioni nuk e ka konsideruar shkelje;
- ç) subjekti ka marrë kredi të butë nga Prokuroria e Përgjithshme në mënyrë jo të rregullt, duke cenuar figurën e prokurorit në këtë rast, pasi kishte banesë dhe kishte ndërtuar pa leje, kredinë e butë e ka përdorur përsëri për blerjen e gjysmës së vilës së vëllait të tij, një pjesë të parave për blerjen e vilës i ka marrë borxh nga kunati, ku nga Komisioni nuk është hetuar mënyra e kthimit të kësaj huaje, duke krijuar kuadrin e një rasti tipik të pastrimit të parave;
- d) Komisioni nuk ka kryer asnjë hetim për hotelin në {***} që, faktikisht, e deklaroi si shtëpi, të cilën prapë e deklaroi në pronësinë e të vëllait, marangoz, por që janë para që rrjedhin nga korrupsioni.

29.4. Sipas Komisionerit, duke marrë në konsideratë denoncimet e sipërcituara dhe rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, evidentohen mangësi të tilla që nuk përmbushin realizimin e kontrollit të kriterit të pasurisë dhe, për këtë arsye, Komisioneri kërkoi një hetim të plotë të pasurive.

29.5. Për pasurinë “shtëpi në {***}”, Komisioneri kërkoi hetim në lidhje me:

- a) evidentimin e situatës faktike të pasurisë së deklaruar “shtëpi në {***}”, në drejtim të funksionit dhe të numrit të kateve të saj;
- b) evidentimin e vlerës së investimit nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë si bashkinvestitorë, për pasurinë e deklaruar “shtëpi në {***}”, referuar dokumentacionit të depozituar për marrjen e lejes së ndërtimit dhe përlllogaritjen e shpenzimeve për godinën në funksion të objektit si strukturë hoteliere;
- c) verifikimin e lejes së ndërtimit për pasurinë e deklaruar “shtëpi në {***}” dhe mënyrën e zbatimit të saj;
- ç) cilësimin eventual si persona të tjerë të lidhur të z. Sh.D. dhe znj. N.D., dhe justifikimin me dokumentacion ligjor të të ardhurave që kanë shërbyer si investim në pasurinë “shtëpi në {***}”.

29.6. Për pasurinë “ndërtesa 3 kate nga 118 m², me truall 274 m²”, Komisioneri kërkoi hetim në lidhje me:

- a) plotësimin e kriterëve për përfitimin nga kredia me kushte lehtësuese;
- b) evidentimin e kohës së përfundimit të katit shtesë 113 m², deklaruar në deklaratën vjetore 2007, gjendja e saj deri në vitin 2011;
- c) burimin e të ardhurave të ligjshme të krijimit të pasurisë “ndërtesa 3 kate nga 118 m², me truall 274 m²”;
- ç) evidentimin e saktë për numrin e kateve dhe pjesën takuese mbi pasurinë “ndërtesa 3 kate nga 118 m², me truall 274 m²”;
- d) ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit dhe të trajtimit preferencial në çmimin e blerjes me më pak se 1.700.000 lekë, nga vlera faktike e ndërtimit nga z. S.D., në favor të z. Sh.D., në konsideratë të fakteve se subjekti banonte në këtë pasuri para transaksionit të shitjes dhe ushtronte detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- dh) vlerësimin eventualisht të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë “ndërtesa 3 kate nga 118 m², me truall 274 m²”, nga personi tjetër i lidhur, z. Sh.D., në varësi kjo të dokumentacionit të administruar për elementin e mësipërm që parashtrohet për hetim.

29.7. Në vijim të denoncimit të z. T.D.¹⁶⁵, protokolluar pranë IKP-së me nr. {***} prot., datë 15.11.2018, dhe në vijim të denoncimit të z. P.N.¹⁶⁶, protokolluar pranë IKP-së me nr. {***} prot., datë 06.12.2018, Komisioneri vlerësoi se nuk përmbanin indicie që mund të ndikonin në kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, duke qenë se lidheshin me zgjidhjen e çështjeve respektive në themel.

29.8. Komisioneri parashtroi se tri ish-in denoncimet e përcjella nga Kolegji, pas depozitimit të ankimit:

- a) z. R.P.¹⁶⁷, protokolluar pranë IKP-së me nr. {***} prot., datë 08.04.2019;
- b) z. S.P.¹⁶⁸, protokolluar pranë IKP-së me nr. {***} prot., datë 10.04.2019; dhe
- c) z. V.Ç.¹⁶⁹, protokolluar pranë IKP-së me nr. {***} prot., datë 04.12.2019.

29.9. Në lidhje me sa denoncoheshin nga z. R.P.¹⁷⁰, Komisioneri evidentoi sa në vijim.

- a) Subjekti i rivlerësimit kishte lidhje të ngushta me trafikantin D.D., si dhe D.K..
- b) Kishte vënë pasuri me anë të korrupsionit dhe citon vilën në {***} dhe hotel në {***}, të cilat i fsheh në emër të familjarëve të tij dhe të vëllait, gjithashtu ka marrë kredi si i pastrehë në kundërshtim me ligjin.
- c) Kishte liruar njerëz nga burgu për tentativë vrasjeje, në vitin 2007.
- ç) Lidhur me anën formale, denoncuesi ishte identifikuar si z. R.P.¹⁷¹.
- d) Aktet e referuara në përmbajtjen e këtij denoncimi ishin trajtuar nga Komisioneri në ankimin e paraqitur para Kolegjit.

29.10. Komisioneri për denoncimin e z. R.P., për sa u përket lidhjeve të ngushta me trafikantët D.K. dhe D.D., parashtroi se nuk kishte indicie të mjaftueshme apo rrethanë që të lidhte subjektin e rivlerësimit me këta persona.

29.11. Në vijim të denoncimit të z. S.P.¹⁷², Komisioneri evidentoi se denoncuesi informonte sa në vijim.

- a) Subjekti i rivlerësimit kishte qenë në hetim për korrupsion dhe kishte çështje në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.
- b) Denoncuesi identifikohet në pozicionin e oficerit në Drejtorinë e Forcave Operacionale në Policinë e Shtetit, dhe se forcat e kësaj drejtorie kishin ndjekur dhe përgjuar subjektin e rivlerësimit me urdhër të prokurorit.
- c) Bazuar në të dhënat e denoncimit, çështjen e kishte pasur në shqyrtim prokurorja D.M., në vitin 2018, dhe nga përmbajtja e akteve të dosjes pretendohet se rezultonte që subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj ishte vëzhguar, filmuar dhe përgjuar për një bashkëpunim me një prokuror të Tiranës, duke u pretenduar po ashtu se kishte

¹⁶⁵ Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP, për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i z. T.D. rezultoi i regjistruar me nr. {***} prot., datë 15.11.2018.

¹⁶⁶ Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP, për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i z. P.N. rezultoi i regjistruar me nr. {***} prot., datë 06.12.2018.

¹⁶⁷ Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i z. R.P. rezultoi i regjistruar me nr. {***} prot., datë 09.04.2019.

¹⁶⁸ Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i z. S.P. rezultoi i regjistruar me nr. {***} prot., datë 10.04.2019.

¹⁶⁹ Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i z. V.Ç. rezultoi i regjistruar me nr. {***} prot., datë 09.04.2019.

¹⁷⁰ Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i z. R.P. rezultoi i regjistruar me nr. {***} prot., datë 09.04.2019.

¹⁷¹ Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i z. R.P. rezultoi i regjistruar me nr. {***} prot., datë 09.04.2019.

¹⁷² Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i z. S.P. rezultoi i regjistruar me nr. {***} prot., datë 10.04.2019.

përfutur prej tyre një vlerë të caktuar financiare në mënyrë të paligjshme, dhe se dosja ndodhej pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Tiranë.

ç) Në këtë rast, formalisht, denoncuesi ishte identifikuar si z. S.P.¹⁷³.

d) Komisioneri sjell në vëmendje të Kolegjit, i cili ushtron juridiksionin kontrollues dhe rivlerësues, se ankimi i tij në rastin konkret është ushtruar për të tria kriteret e rivlerësimit.

29.12. Komisioneri, për denoncimin e z. S.P., parashtroi se denoncimi në fjalë është depozituar pranë Kolegjit pas depozitimit të ankimit nga ana e Komisionerit Publik. Nisur nga pozita procedurale e posaçme, Komisioneri, në rastin e këtij denoncimi, vlerësoi se ishte në pamundësi për të mbledhur qoftë dhe indicie që vinte nga dokumentacioni i administruar nga institucionet publike dhe private, dhe referuar pikës 2 të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, denoncimi konkret, në dukje, përmbante të dhëna që mund të verifikoheshin pranë prokurorisë përkatëse, në rast se ishin të vërteta apo të rreme.

29.13. Në vijim të denoncimit të z. V.Ç.¹⁷⁴, Komisioneri evidentoi pretendimin e denoncuesit se subjekti i rivlerësimit në funksionin e Drejtorit të Inspektimit në Prokurorinë e Përgjithshme, me anë të dy letrave kthim përgjigje, të datës 24.12.2008 dhe 21.05.2014, e ka dëmtuar seriozisht, duke shkelur rëndë detyrën shtetërore.

29.14. Komisioneri, për denoncimin e z. V.Ç., parashtroi se nuk përmbante shkaqe të mjaftueshme për vlerësimin e pretendimeve.

30. Me anë të shkresës depozitim i provave shtesë, datë 16.01.2020, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj¹⁷⁵ paraqiti dokumente shtesë në funksion të pretendimeve të ngritura, sipas renditjes së mëposhtme.

30.1. Dokumentet e ardhura nga ShBA-ja¹⁷⁶, si më poshtë.

30.1.1. Deklaratë noteriale e shtetasve amerikanë, z. R.D. dhe z. H.S., që mban datën 12.24.19¹⁷⁷, e nënshkruar para një noteri amerikan, e shoqëruar me vulën *apostille* nr. {***}, datë 27.12.2012, e përkthyer në shqip sipas vërtetimit përkthimit nr. {***} rep., datë 14.01.2020, dhe në përmbajtje, z. R.D. dhe z. H.S. shprehimisht kanë deklaruar se: “Ne shtetasit amerikanë R.D. dhe H.S. kemi punuar së bashku që nga viti 2003 dhe kemi krijuar në vitin 2007 kompaninë {***}, e cila kishte si objekt aktivitetin e saj. Ne të dy kemi të drejtë të kryejmë çdo transaksion për kompaninë. Në datën 27.07.2007 nga Banka {***} ShPK, New York, ShBA., nga nr. i llogarisë së kompanisë {***}, kemi bërë një transfertë prej 300.318 USD, e cila u transferua në llogarinë e z. Sh.D. në {***}, Tiranë, Shqipëri. Në këtë transfertë, deklaruesit kanë nënshkruar së bashku, përkatësisht të dy, R.D. dhe H.S., sepse fondet e dhëna dhe transfertat në Shqipëri ishin bërë

¹⁷³ Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i z. S.P. rezulton i regjistruar me nr. {***} prot., datë 10.04.2019.

¹⁷⁴ Sipas listimit të denoncimeve të administruara në IKP për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj, denoncimi i z. V.Ç. rezulton i regjistruar me nr. {***} prot., datë 09.04.2019.

¹⁷⁵ Shkresa depozitim i provave shtesë, datë 16.01.2020, e subjektit të rivlerësimit, ku ky i fundit shprehet se: “Në përgjigje të ftesës suaj të bërë në përfundim të seancës gjyqësore të zhvilluar në datën 16.12.2019, më lejoni të depozitohet provat e mëposhtme shtesë, që vlerësoj se i shërbejnë gjithashtu shqyrtimit të plotë të çështjes dhe u përgjigjen edhe kërkesave të Komisionerit Publik, të shprehura në seancën e asaj date”. Bashkëlidhur kësaj shkrese janë edhe 7 (shtatë) akte shoqëruese, sipas listimit të bërë nga subjekti i rivlerësimit.

¹⁷⁶ Në lidhje me të cilat subjekti i rivlerësimit parashtroi se z. R.D. dhe z. H.S. shpjegojnë se transfertat prej 300.318 USD është bërë nga numri i llogarisë së firmës së përbashkët {***} dhe për transferimin e shumës së dërguar kanë firmosur të dy së bashku si bashkëthemelues të firmës së sipërcituar, dhe se në deklaratën e tyre noteriale konfirmohet se kjo transfertë është kryer për llogari të z. H.S.

¹⁷⁷ Vërej se në datën sipas deklaratës është muaji përpara, pason data dhe më pas viti, sepse vula *apostille* nr. {***} mban datën 27.12.2019.

përmes llogarisë së firmës me Bankën {***} ShPK, New York dhe, për pasojë, kërkohej nënshkrimi i të dy personave për të mundësuar transferimin e parave. Shuma prej 300318 USD është bërë në emër të partnerit tim të biznesit H.S., dhe për aspektin financiar të kompanisë ishte parashikuar që kjo shumë të mbulohej nga kontributi H.S. [..]”.

30.1.2. Veprim noterial i huaj, datë 14.10.2007, i nënshkruar para një noteri amerikan, i shoqëruar me vulën *apostille* nr. {***}, datë 27.12.2012, i përkthyer në shqip sipas vërtetimit përkthimit nr. {***} rep., datë 14.01.2020, dhe nga përmbajtja e këtij akti noterial amerikan, shprehimisht rezulton se: “Sot, më 14.10.2005, përpara meje, noter publik për shtetin e Pensilvanisë, me banim në qytetin e {***}, shteti i Pensilvanisë, u paraqitën personalisht R.D., H.S., nëpunësi i nënshkruar R.D.H., identifikuar prej meje (e dëshmuar) si personat emrat e të cilëve janë nënshkruar në këtë dokument, dhe që janë në dijeni që ky dokument ekzekutohet për të njëjtat qëllime që përmbahen këtu. Unë vendos këtu nënshkrimin dhe vulën time”.

30.1.3. Kontratë e datës 06.06.2008, e nënshkruar nga z. R.D. dhe z. H.S. në datën 11.20.08¹⁷⁸ para një noteri amerikan, e përkthyer në shqip sipas vërtetimit përkthimit nr. {***} rep., datë 14.01.2020, dhe nga përmbajtja e kësaj kontrate, shprehimisht rezulton se: “Vendi i punës {***} - Shprehim kënaqësinë tonë që na është dhënë mundësia ta paraqesim këtë kontratë si vijon për punimet që duhet të përfundojnë në vendin e mësipërm: Për sip. 10200 SQFT¹⁷⁹ në total kushton 9 USD. 1). Riparimi i të gjitha linjave anësore në të gjithë ndërtesën. 2). Riparimi dhe zëvendësimi i të gjitha tullave të rëna dhe që mungojnë. 3). Aplikimi me veshje me bazë akrilike, duke mbuluar gjithë muret e jashtme të ndërtesës. 4). Aplikimi me shtresën e dytë të stukos, duke niveluar zonat ku është e nevojshme. 5). Aplikimi i shtresës përfundimtare me stuko akrilike, me ngjyrën që kanë zgjedhur pronarët. 6). Të gjitha bravat e dritareve dhe dyerve do të kenë ngjyra të ndryshme. 7). Veshja me gur në anën veriore të ndërtesës. 8). Instalimi i 60 parrmakëve UGC 116 në pjesën e përparme dhe në njërin anë të ndërtesës. 9). Instalimi i çatisë së sipërme në 3 hyrjet e ndërtesës. 10). Çmimi total për stukimin llaç 91800 USD. 11). Shtimi i trotuareve 2000 SQ FT për SQ FT 24.000 USD. 12). Heqja e betonit ekzistues nga trotuari. 13). Aplikimi me zhavorr për mbulimin e zonës. 14). Kompresimi i zhavorrit. 15). Betoni i oborrit të shtëpisë, kostoja totale 9000 USD. 16). Instalimi i betonit 3500 lb që mbulon oborrin e shtëpisë dhe pjesën veriore. 17). Instalimi i shtresës me tulla në 2 ½ anët e ndërtesës. Çmimi total, përfshirë materialet, 124.800 USD. E gjithë puna do të bëhet në mënyrë profesionale dhe në kohë. Pagesat do të bëhen si më poshtë. Depozitoni 4000 USD deri në nënshkrimin e kontratës, bilanci që do të paguhet kur puna përparon. 10% e fundit, kur puna është e përfunduar dhe aprovuar”.

30.1.4. Shkresë, datë 02.06.2009, e {***} & {***} (Zyrë Avokatie), e përkthyer në shqip sipas vërtetimit përkthimit nr. {***} rep., datë 14.01.2020, me lëndë: “Përgjigje: {***} {***} Filadelfia PA Marrëveshje për ndryshimin dhe zgjerimin e hipotekimit dhe notës”, dhe nga përmbajtja, shprehimisht rezulton se: “I dashur z. D., bashkëngjitur është një kopje e marrëveshjes për ndryshimin dhe zgjerimin e hipotekimit. Do të vini re që pagesat janë kryer më 15 mars, 15 prill dhe 15 maj, megjithatë këto pagesa kanë qenë vetëm në vlerën 1.500.000 USD. Pagesa e saktë mujore është 1.566,86 USD, e cila duhet të paguhet në ose para datës 15 të çdo muaji. Pagesat aplikohen së pari për interesin, kështu, që për të sjellë llogarinë aktuale mbi pagesën tuaj për periudhën 15 qershor, ju lutem të siguroni çekun që duhet të paguhet në shumën prej 1.767,44 USD. Më pas ju do të jeni koherent dhe skeduli i amortizimit do të pasqyrojë me saktësi shlyerjen e kredisë. Ju lutem të vazhdoni të kryeni pagesat direkt te D.L. në Florida dhe më kontaktoni për çdo pyetje”.

¹⁷⁸ Në datën sipas deklaratës është muaji përpara, pason data dhe më pas viti, sepse vulla *apostille* nr. {***} mban datën 27.12.2019.

¹⁷⁹ Square feet, njësi matëse 1 = 0,3048 m².

30.2. Fotografi të materialeve në objekt të ardhura nga ShBA-ja¹⁸⁰ dhe të zhdoganuara sipas urdhër çlirimeve më poshtë.

- a) Urdhër çlirimi, datë 25.09.2014, në emër të z. Sh.D.
- b) Urdhër çlirimi, datë 27.10.2015, në emër të z. Sh.D.; dhe
- c) urdhër çlirimi, datë 27.10.2015, në emër të z. M.D.

30.3. Deklarata noteriale¹⁸¹ nr. {***} rep., datë 14.01.2020¹⁸², e z. M.D., i cili shprehimisht ka deklaruar se: “Unë, i nënshkruari M.D., kam djalë xhaxhai Sh.D.. Më datë 27.10.2015, unë me Sh. kemi shkuar te porti i Durrësit pasi ai priste një sasi malli që vinte me kontejner dhe pastaj kemi shkuar te sheshi i kontejnerëve në port. Për të tërhequr materialet kemi përdorur dhe një automjet të tonazhit të rëndë, pasi kishte sasi të madhe materiali që do të transportohej për Tropojë. Mallrat i kishte dërguar H.S. (kunati i Sh.), i cili jeton në ShBA, të cilat do t’i përdorte në shtëpinë në {***} . Gjatë procedurës së zhdoganimit është shënuar dhe emri im si pritës malli, për shkak se kishte dhe mallra të personave të tjerë në kontejner dhe duhej që, sipas vendosjes së mallrave, të bëhej dhe zhdoganimi. Në këto rrethana, për të fituar kohë, pasi shkarkimi i kontejnerit do të bëhej me pjesë, është shënuar dhe emri im që të bëhej ngarkimi i një pjese të mallit (në automjetin që do të bëhej transporti), në pritje të zhdoganimit të pjesës tjetër të mallit. Mallrat e zhdoganuara ishin të llojeve të ndryshme, si: parket, mbulesë çatie, kolltukë, mobilie druri, si: etazher, dollapë, pajisje tavoline, abazhur etj. Këto materiale kanë qenë të H. dhe Sh. dhe nuk kam marrë asgjë nga këto materiale. Pas zhdoganimit, e gjithë sasia e mallit është ngarkuar në trailer dhe është dërguar në {***} , Tropojë”.

30.4. Shkresa e Prokurorisë së Përgjithshme nr. 825/2 prot., datë 10.01.2020, me lëndë “kthim përgjigjeje”, drejtuar z. Arben Dollapaj, nga e cila rezulton se: “Prokuroria e Përgjithshme, në përgjigje të shkresës nr. {***}, datë 08.01.2020, si dhe në vijim të vërtetimit nr. {***}, datë 18.03.2019, për pagesat e kryera si anëtar i Këshillit të Prokurorisë për vitet 2001-2004 dhe 2015-2016, bën me dije se është mbajtur tatimi në burim dhe është derdhur në Degën e Tatimeve Tiranë”. Nga kërkesa e datës 08.01.2020 e z. Arben Dollapaj, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se ai ka parashtruar se me shkresën nr. {***}, datë 18.03.2019¹⁸³, i ishin konfirmuar pagesat që kishte marrë si anëtar i Këshillit të Prokurorisë, për vitet 2001-2004 dhe 2015-2016, në vijim paraqiste kërkesën për t’iu konfirmuar fakti, nëse ishin mbajtur tatimet për këto pagesa nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme.

30.5. Kërkesa (e-mail) e datës 07.01.2020, drejtuar Drejtorisë së Tatimeve¹⁸⁴, nga ku rezulton se në datën 07.01.2020, nga adresa elektronike {***} , drejtuar {***} dhe {***}, me subjekt:

¹⁸⁰ Subjekti i rivlerësimit parashtron se të gjitha mallrat e ardhura nga ShBA-ja janë përdorur për arredimin e bujtinës në pronësi të vëllait dhe motrës së tij në {***} , qartazi në to shfaqet se prodhimi është “Made in U.S.A.”, si dhe pasqyrohen disa mallra të tjera që vetëshpjegojnë se janë përdorur vetëm për arredimin e bujtinës - duke parë llojin e materialeve të përdorura dhe mobilieve në arredim të zhdoganuara, lehtësisht konstatohet se këto materiale dhe mallra nuk gjenden në tregun vendas. Nga pamjet fotografike, duken fotografi të mbulesës së çatisë, të veshjes së jashtme të objektit, të abazhurëve, të karrigeve dhe tavolinave; fleta nr. 22 janë kolltukët; dhe fleta nr. 23 është parketi.

¹⁸¹ Bashkëlidhur deklaratës noteriale nr. {***} rep., datë 14.01.2020, është edhe letërnjoftimi nr. {***} i z. M.D.

¹⁸² Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë deklaratë parashtrroi se ai kishte qenë i pranishëm kur ishte bërë zhdoganimi i materialeve dhe kishte shkuar vetë për të ndihmuar z. Sh.D., pasi të gjitha mallrat ishin dërguar njëherësh me trailer në Tropojë, në fshatin {***} , dhe se emri i tij ishte shkruar vetëm për të përshpejtuar procedurat e zhdoganimit dhe për të bërë të mundur ngarkimin në automjetin që do të bënte transportin e mallrave në Tropojë.

¹⁸³ Në kërkesën e datës 08.01.2020 të z. Arben Dollapaj, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, kërkuesi, z. Arben Dollapaj, ka vendosur në kllapa shprehjen “bashkëlidhur shkresa”, por që nuk rezulton ta ketë bashkëlidhur edhe fizikisht në Kolegj.

¹⁸⁴ Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë kërkesë, parashtrroi se kishte kërkuar t’i konfirmonin nëse për pagesën që kishte përfituar në vitin 2008 si pedagog i jashtëm, subjekti tatimpagues “Shkolla e Lartë Universitare JoPublike Universiteti {***}”, kishte kryer pagesën e tatimit për të ardhurat e përfituara prej tij për shkak të të qenit pedagog i jashtëm pranë tij, sipas nenit 2.6.1. të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, dhe nenit 10 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, dhe se autoriteteve

paraqitje kërkesë, rezulton të jetë dërguar kërkesa e z. Arben Dollapaj, përfaqësuar nga av. Viktor Gumi, drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj (në vijim “DTM”) dhe DRT-së Tiranë, shprehimisht, si në vijim: “Në vitin 2008 kam ushtruar për disa muaj detyrën e pedagogut të jashtëm pranë Shkollës së Lartë Universitare JoPublike Universiteti {***}. Për nevoja të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, lutemi më konfirmoni nëse për pagesën që kam përfituar për këtë periudhë kohore, subjekti tatimpagues Shkolla e Lartë Universitare JoPublike Universiteti {***} ka kryer pagesën e tatimit për të ardhurat e përfituara prej meje për shkak të të qenit pedagog i jashtëm pranë tij, sipas nenit 2.6.1. të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe nenit 10 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”. Ju bëj me dije se Shkolla e Lartë Universitare JoPublike Universiteti {***} ka mbyllur aktivitetin e saj arsimor në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 06.08.2014. Bashkëlidhur po ju paraqes edhe *statement* bankar të {***} për pagesat e kryera nga ky subjekt për angazhimin tim si pedagog i jashtëm¹⁸⁵”.

30.6. Kërkesat (*e-mail*) në datat 13.09.2019 dhe 22.10.2019 drejtuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, përkatësisht: i) rezulton se në datën 22.10.2009, nga adresa elektronike {***}, drejtuar {***}, me subjekt “Kërkesë për të dhëna”, shprehimisht rezulton: “Në datën 13 shtator kam paraqitur një kërkesë. Duke qenë se ka kaluar mbi një muaj dhe nuk kam marrë asnjë njoftim, kërkoj nga ana juaj të më kthehet një përgjigje në përmbushje të detyrave”; dhe ii) në datën 13.09.2019, nga adresa elektronike {***}, drejtuar {***}, me subjekt “Kërkesë për të dhëna”, shprehimisht rezulton: “Më quajnë Arben Dollapaj. Jam subjekt i procesit të rivlerësimit (*vetting*) të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Për nevoja të këtij procesi, kërkoj një vërtetim (konfirmim me shkrim) në lidhje me nxjerrjen ose jo, nga ana ime të siguracionit TPL, apo karton jeshil për automjetet: Mercedes-Benz me targë {***} dhe B.M.W. me targë {***} - gjeneralitetet: Arben M. Dollapaj, datëlindje 17.12.1969. Për informacion më të hollësishëm mund të më kontaktoni në numrin {***}”.

30.7. C.D. 1 (një), video e shtëpisë së subjektit të rivlerësimit në {***} , e bërë në datën 10.01.2020¹⁸⁶.

31. Në përgjigje të kërkesës, datë 05.02.2020, të dërguar nga gjyqtari relator i çështjes, në përputhje me vendimin e ndërmjetëm, datë 04.02.2020, të trupit gjykues të Kolegjit, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim “SPAK”), dërgoi në Kolegj shkresën nr. {***} prot., datë 14.02.2020, me anë të së cilës informonte se në regjistrin e njoftimit të veprave penale të SPAK-ut, nuk rezultonte që në emër të z. Arben Dollapaj, të kishte filluar procedim penal apo të ishte bërë ndonjë kallëzim kundër tij.

31.1. Gjithashtu, SPAK-u informonte se pas verifikimit të regjistrimit të veprave penale të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (në vijim “PPGjShPKR”), nuk rezultonte që në emër të z. Arben Dollapaj të kishte filluar procedim penal, apo të ishte bërë ndonjë kallëzim kundër tij.

32. Në seancën gjyqësore, datë 25.02.2020, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj paraqiti para trupit gjykues të Kolegjit edhe dokumentet e mëposhtme.

*shtetërore të mësipërme u ishte drejtuar sepse “Shkolla e Lartë Universitare JoPublike Universiteti {***}” kishte mbyllur aktivitetin arsimor, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 06.08.2014.*

¹⁸⁵ *Në kërkesën e datës 07.01.2020 të av. Viktor Gumi, drejtuar {***} dhe {***}, av. Viktor Gumi është shprehur se ka bashkëlidhur edhe *statement* bankar, por që nuk rezulton ta ketë paraqitur edhe fizikisht në Kolegj.*

¹⁸⁶ *Subjekti i rivlerësimit parashtroi se ai e paraqiste këtë video për të konfirmuar se ambientet e shtëpisë së subjektit të rivlerësimit në {***}, të bëra vetëm pak ditë më parë, janë të ndara nga ambientet e bujtinës së vëllait dhe motrës së tij, dhe qartazi, sipas subjektit të rivlerësimit, në video pasqyrohet edhe fakti që shtëpia e subjektit të rivlerësimit në {***} është ende e papërfunduar si ndërtime. Nga pamjet filmike, janë filmuar ambientet e brendshme të një ndërtese, një kat përdhes dhe dy kate mbi atë përdhes, për të cilën nuk kanë përfunduar plotësisht punimet ndërtimore të brendshme.*

- 32.1.** Derdhje për thesarin e {***} Bank, datë 04.12.2013, e urdhëruesit, z. Sh.D., në shumën totale prej 61919 lekësh, me përshkrimin “F.D. {***} Komuna Margegaj {***}, të tjera tarifa admini”.
- 32.2.** Plani i lidhjes së strukturës me infrastrukturën, Tiranë 2013, objekti “Rikonstruksion dhe shtesë kati objekti 2k dhe papafingo, Komuna Margegaj, Tropojë, zk {***}, nr. pas. {***}, në pronësi të znj. F.D.”, i arkitekt A.B., arkitekt A.V., arkitekt E.A. dhe arkitekt R.G., të miratuar nga Komuna Margegaj, Ujësjetllësi ShA Tropojë, CEZ Shpërndarje ShA, Albtelecom ShA, Prefekti i Qarkut Kukës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
- 32.3.** Plani i katit të parë, Tiranë 2010, objekti “Rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti {***} dhe papafingo”, i arkitekt E.A.
- 32.4.** Impianti i furnizimit me ujë sanitar “Rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti {***} dhe papafingo”, i ing. hidraulik F.K. dhe ing. L.D.
- 32.5.** Impianti i mbrojtjes kundër zjarrit “Rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti {***} dhe papafingo”, i ing. hidraulik F.K. dhe ing. L.D.
- 32.6.** Impianti i shkarkimit të ujërave të zeza, “Rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti {***} dhe papafingo”, i ing. hidraulik F.K. dhe ing. L.D.
- 32.7.** Hollësi të armimit të travetave me polisterol, Tiranë 2013, “Rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti {***} dhe papafingo”, i ing. Dh.S., ing. E.P. dhe ing. K.D.
- 32.8.** Detaje të lidhjes së hekurit, Tiranë 2013, “Rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti {***} dhe papafingo”, i ing. Dh.S., ing. E.P. dhe ing. K.D.
- 32.9.** Armimi i plintit pl 1, Tiranë 2013, “Rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti {***} dhe papafingo”, i ing. Dh.S., ing. E.P. dhe ing. K.D.
- 32.10.** Armimi i kolonës K1 30 x 50, Tiranë 2013, “Rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti {***} dhe papafingo”, i ing. Dh.S., ing. E.P. dhe ing. K.D.
- 33.** Në përfundim të parashtrimeve përfundimtare, datë 05.03.2020, sipas Komisionerit, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj rezultonte me mungesë të burimeve financiare dhe ai nuk arriti të justifikonte bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të deklaruara prej tij dhe të personave të lidhur me të, duke kryer sipas Komisionerit, deklaram të pamjaftueshëm dhe duke cenuar besimin e publikut në vlerësimin tërësor të procedurave dhe, për këto arsye, Komisioneri, bazuar në pikat 3 dhe 7 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës, shkronjën “b” të pikave 3 dhe 5 të nenit 61, në pikën 1 të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi: “Ndryshimin e vendimit nr. 63, datë 6.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, magjistrat/prokuror, aktualisht anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.
- 33.1.** Për pasurinë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si “shtëpi banimi, në fshatin {***} Tropojë”, Komisioneri pretendoi se subjekti i rivlerësimit kishte kryer deklaram të pasaktë, të paplotë, kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke kryer në këto rrethana deklaram të pamjaftueshëm, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, pasi sipas Komisionerit:
- a) nuk arriti të provojë vlerën e totalit të investimit, ashtu dhe vlerën e investimit për pjesën takuese të tij në këtë ndërtesë;
 - b) nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, z. Sh.D. dhe znj. N.D.;

e) kishte kryer deklarim të pamjaftueshëm lidhur me gjendjen faktike të kësaj pasurie, pasi është regjistruar pranë QKB-së në datën 27.07.2016, si sipërmarrje private¹⁸⁷, sikurse edhe për sa i përket sipërfaqes totale apo numrit të kateve që ai posedon në këtë ndërtesë;

ç) nuk provohej se leja zhvillimore dhe ajo ndërtimore, datë 05.03.2013, të jenë dhënë në përputhje me ligjin nr. 10119/2010, edhe për sa i përket zhvillimit të ndërtimeve në zonat e mbrojtura “Park Kombëtar”¹⁸⁸.

33.2. Për pasurinë “ndërtesë 3-katëshe në rr. “{***}”, Tiranë”, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me të vëllain, z. Sh.D., Komisioneri pretendoi se subjekti i rivlerësimit kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme, kishte kryer deklarim të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe kishte cenuar etikën e magjistratit në përfitimin e kredisë së butë për strehim, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës, pasi sipas Komisionerit:

a) gjendej në kushtet e deklarimit të pasaktë sepse në deklaratën *vetting* nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie për vlerën 9000.000 lekë;

b) gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për huan në shumën 25000 USD, sepse provat dhe aktet e paraqitura mbi këtë shkak nuk konsiderohen si dokumentacion justifikues ligjor mbi burimin e ligjshëm të huas së dhënë nga kunati tij, z. H.S.;

c) gjendej në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e shtesës së katit me sipërfaqe 113 m², në vlerën 1700.000 lekë, duke rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme në shumën 810.767 lekë;

ç) referuar mandatpagesës së Bankës {***}, datë 03.03.2011, kryer nga z. Arben Dollapaj, administruar gjatë hetimit administrativ në lidhje me taksën vendore për ndikimin në infrastrukturë të ndërtimit që legalizohet, rezultoi se vlera e investimit për katin shtesë është 3.638.807 lekë, vlerë kjo që e rrit diferencën negative të konstatuar me një shumë prej 1.938.807 lekësh, në referencë të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për ndërtimin nga ana e subjektit të rivlerësimit të shtesës së katit.

d) kur objekti shtesë kati kishte qenë i përfunduar, rezultonte se subjekti i rivlerësimit ishte trajtuar me kredi të butë për strehim, në një kohë (datë 18.05.2011) kur posedonte sipërfaqe banimi për veten dhe familjen e tij¹⁸⁹.

33.3. Për dhuratat e të afërmeve, në shumën totale 10.900 USD e 200 euro, dhe diferencat negative ndër vite, Komisioneri konstatoi se qëndrimet e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të detyrimit për të provuar të kundërtën, mbeten më së shumti në nivel deklarativ dhe nuk u arrit të provohet bindshëm burimi i ligjshëm i të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive të deklaruara, përkundër shkaqeve të ankimit, në lidhje me diferencat negative të konstatuara ndër vite¹⁹⁰, pasi sipas Komisionerit:

a) referuar dokumentacionit justifikues të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit në Kolegj, nuk provohej se dhuruesit, znj. V.T., znj. D.N. dhe znj. V.D., kishin të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për t'i dhuruar shumat e deklaruara subjektit të rivlerësimit;

¹⁸⁷ Me objekt aktiviteti “Bujtinë, shtëpi pritjeje (Guest - House)/strukturë hotelerie”.

¹⁸⁸ Sipas vendimit nr. 102, datë 15.01.1996, të Këshillit të Ministrave, me të cilin “Lugina e {***}” është shpallur “Park Kombëtar”.

¹⁸⁹ Sa më lart, sipas Komisionerit, duhet të vlerësohet duke iu referuar jurisprudencës së këtij Kolegji, për rastet e përfitimit të kredisë së butë për strehim nga subjektet e rivlerësimit, në kushtet e mosplotësimit të kriterëve ligjore dhe ndikimit të këtij elementi në vlerësimin e etikës dhe vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit.

¹⁹⁰ Përveç shumës së dhuruar nga mbesa e subjektit, znj. E.T., në vlerën 2000 USD.

b) lidhur me të ardhurat nga dhuratat, rezultonte se subjekti i rivlerësimit nuk kishte paguar detyrimet tatimore në zbatim të udhëzimit të MF-së nr. 5/2006¹⁹¹.

34. Në të kundërt, në përfundim të konkluzioneve përfundimtare, datë 05.03.2020, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj kërkoi: “Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 63, datë 06.08.2018. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, zotit Arben Dollapaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër”, duke iu referuar jurisprudencës së GjEDNj-së¹⁹².

34.1. Shprehimisht sipas konkluzioneve përfundimtare të subjektit të rivlerësimit: “[...] z. Arben Dollapaj, sipas nenit 6 të KEDNj-së, nuk mund t’i kërkohet llogari në vitin 2020 se pse dhe si motra e tij i ka dhuruar në vitin 2006 shumën prej 1000 USD për të dhe nënën e saj që jeton me subjektin e rivlerësimit [...]”, si dhe të parimit të proporcionalitetit¹⁹³, duke theksuar se: “[...] kur bashkërisht qëmtojmë nëse Universiteti {***} ka zbatuar detyrimin ligjor për të paguar 52 euro tatim për të ardhurat që subjekti ka përfituar si lektor i jashtëm apo 200 euro që vjehrrin i ndjerë u ka dhënë dhuratë fëmijëve të subjektit në vitin 2013 [...]”.

34.2. Për sa i përket huas prej 25.000 USD nga z. H.S., subjekti i rivlerësimit pretendoi se transaksioni ishte bërë nëpërmjet {***} Bank, një prej bankave më të mëdha në ShBA, që garantonte ligjshmërinë dhe burimin e transaksionit, me synimin për të vërtetuar gjendjen shumë të mirë financiare të z. H.S., dhjetëra herë më të madhe se shumata e dhënë hua, sipas subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, subjekti i rivlerësimit referonte në ekstraktin tregtar të shoqërisë {***}, në informacionin individual për të ardhurat vjetore të kumatit, z. H.S., dhe të bashkëshortes së tij, znj. N.R.¹⁹⁴, në marrëveshjen përmbyllëse të shoqërisë tregtare {***} me {***} Bank, sipas letrës së angazhimit no {***}, datë 29.05.2009 dhe dokumentin përmbyllës për veprimin, datë 29.05.2009, të {***}¹⁹⁵, në pasqyrën financiare të Bankës {***} në emër të z. H.S., sipas së cilës bilanci përmbyllës për periudhën 08.01.2014 - 29.08.2014, gjendja në llogarinë e tij bankare ishte në shumën 2.164.254,83 USD, dhe në formularin e deklaratës së të ardhurave të ortakërisë, që relatonte të ardhura nga aktiviteti i qiradhënies për vitin 2018, me anë të të cilit vërtetohet totali i asetëve për shumën 3.582.129 USD.

34.3. Subjekti i rivlerësimit parashtroi se vlerësimet e mësipërme ishin po njëjloj të vlefshme edhe për transfertën bankare prej 300.318 USD nga kunati, z. H.S., në datën 27.07.2007, nga

¹⁹¹ Si rrjedhim, sipas Komisionerit, mospërfshirja e dhurimeve si të ardhura të ligjshme në analizën financiare çon në konkluzionin se subjekti nuk mbulonte me burime të ligjshme pagesat, shpenzimet dhe investimet e kryera edhe për vitet 2006, 2008 dhe 2013.

¹⁹² Vendimet e GjEDNj-së për çështjen “Oleksadr Volkov k. Ukrainës”, datë 09.01.2013, paragrafi 137 dhe çështjen “Dimitrovi k. Bullgarisë”, datë 03.03.2015, paragrafi 47.

¹⁹³ Duke cituar “House of Lords, R. k. Goldstein (1983) 1 WLR 151, 155”, (https://www.doj.gov/hk/eng/public/basiclaw/basic15_2.pdf), sipas të cilit atë që Dhoma e Lordëve në Plain English ka vendosur në 1983 si përkufizim të proporcionalitetit: “You must not use a steam hammer to crack a nut if a nutcracker would do”.

¹⁹⁴ Subjekti i rivlerësimit parashtroi se në pjesën D të kësaj deklaratë listohen gjithsej 7 prona të paluajshme të cilat kanë një vlerë prej 10.900.000 USD dhe për të cilat prej tyre është marrë kreditim nga bankat prej vitit 2007 e në vazhdim, gjithsej 3.713.025 USD dhe, siç shihet, sipas subjektit të rivlerësimit, ky situacion konfirmon faktin se ata kanë pasur dhe vijojnë të kenë situatë shumë të mirë financiare, të krijuar vit pas viti, jo vetëm nga kreditë, por edhe nga të ardhurat nga biznesi i tyre.

¹⁹⁵ Subjekti i rivlerësimit parashtroi se në datën 29 maj 2009, pra që përkon edhe me kohën para vitit 2010 në të cilën është realizuar kontrata e huas prej kumatit të tij, shoqëria tregtare {***} ka hartuar dhe firmosur marrëveshjen përmbyllëse sipas legjislacionit amerikan me {***} BANK, bankë kursimesh në USA Pennsylvania, për shumën prej 1.100.000 USD. Bashkëlidhur kësaj shkresë është edhe letra e angazhimit no {***} e datës 29 maj 2009. Për këtë gjë, ai paraqiti si dokumentacion tjetër shoqërues edhe {***}, nr. i dosjes {***}, Dokumenti Përmbyllës për veprimin e datës 29 maj 2009.

{***}, New York, SHBA, e cila ka kaluar në llogarinë e vëllait të tij në {***}, Tiranë, Shqipëri¹⁹⁶.

34.4. Në lidhje me marrjen e kredisë lehtësuese për strehim, subjekti i rivlerësimit parashtroi se në mbështetje të pikës 1 të vendimit të KM-së nr. 600/2007¹⁹⁷, të nenit 52, pikat 2 dhe 7, të ligjit nr. 8737/2001¹⁹⁸, është miratuar urdhri i kryeministrit nr. 122/2020, ku ishte parashikuar një fond kredie prej 10 kuota për prokurorinë shqiptare, periudhë në të cilën subjekti i rivlerësimit theksoi se ishte në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe, si pasojë, i plotësonte kriteret për të marrë kredi, sikurse iu komunikua nga Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr. {***} prot., datë 01.07.2010.

34.5. Për destinacionin e kredisë me kushte lehtësuese, subjekti i rivlerësimit parashtroi se kishte qenë pikërisht për t'i mundësuar strehimin e tij dhe të familjes në katin e dytë të shtëpisë së vëllait të tij, z. Sh.D., kohë në cilën, sipas tij, në atë kat ishin kryer punime thelbësore, por të papërfunduara për të qenë i gatshëm për banim.

34.6. Sipas subjektit të rivlerësimit, fakti që ishte paguar taksa e ndikimit në infrastrukturë në datën 03.03.2011, nuk ka asnjë lidhje ligjore me përfundimin ose jo të punimeve të ndërtimit, duke theksuar se sipas legjislacionit në fuqi, legalizimi bëhej edhe për objektet ndërtimore në stadin e karabinasë.

34.7. Në lidhje me shtëpinë në {***}, subjekti i rivlerësimit parashtroi se ishte ndërtuar një objekt i cili vetëm pjesërisht ishte në pronësi të tij¹⁹⁹ dhe se një pjesë e mirë e objektit ishte në pronësinë e vëllait, z. Sh.D., dhe motrës, znj. N.D.²⁰⁰, duke sqaruar gjithashtu se ky objekt kishte pasur destinacion shërbimi social, ku banonin familjarët e punëtorëve dhe, në këto rrethana, nuk ka ndërruar destinacion. Akti i ekspertimit, vijon subjekti i rivlerësimit, paraqet gjendjen aktuale të godinës, njëkohësisht CD-ja e cila përmban video dhe pamje të ditëve të fundit të gjendjes së objektit.

34.8. Për pasojë të mungesës së dokumentacionit në ish-komunën Margegaj në lidhje me lejet e ndërtimit/zhvillimit, datë 05.03.2013, sipas subjektit të rivlerësimit gjendemi para një rasti të veçantë, por jo për fajin e tij²⁰¹, por se nga ana tjetër, theksoi, se lejet përkatëse të lëshuara

¹⁹⁶ Subjekti i rivlerësimit parashtroi se kjo transfertë është bërë nga shtetasit amerikanë, z. H.S. dhe z. R.D., të cilët kishin që prej vitit 2003 që bashkëpunonin nëpërmjet krijimit të një firme të përbashkët në SHBA, dhe se transfertat është firmosur nga të dy të lartpërmendurit dhe palët kanë shprehur qëllimin e vërtetë se është bërë për llogari të z. H.S., ndryshe nga sa pretendon Komisioneri, ordering customer, në dokumentin e paraqitur nga Banka {***}, ish-{***}, është z. R.D. së bashku me z. H.S..

¹⁹⁷ Sipas citimit të subjektit të rivlerësimit, pika 1 e vendimit të KM-së nr. 600/2007, parashikonte se: “Në kuptim të këtij vendimi me funksionarë politikë dhe nëpunës civilë të administratës së lartë shtetërore që trajtohen me strehim nënkuptohen: [...] c) anëtarët e Gjykatës Kushtetutës dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm [...] f. gjykatësit e gjykatave të apelit dhe të gjykatave të rretheve gjyqësore [...]”.

¹⁹⁸ Sipas citimit të subjektit të rivlerësimit, pikat 2 dhe 7 të ligjit nr. 8737/2001, parashikojnë se: “[...] 2). Paga e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme është e barabartë me pagën e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Paga e drejtuesve të hallkave, që janë prokurorë në strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme, është 5 për qind më e lartë se paga e prokurorëve të kësaj prokurorie [...] 7). prokurorët dhe drejtuesit e tyre kanë të njëjtat trajtime dhe status protokollar si gjyqtarët dhe drejtuesit e gjykatave, pranë të cilave ushtrojnë funksionet prokuroria, përveçse kur ligji parashikon ndryshe”.

¹⁹⁹ Në pjesën anësore të tij, ka një hyrje të veçantë pa komunikim me pjesën tjetër të objektit, në të cilën nuk kanë përfunduar ende instalimet hidraulike, elektrike, shtrimet e dhomave etj., dhe se kjo strukturë e objektit, sipas subjektit të rivlerësimit, është parashikuar që në projektin e rikonstruksionit dhe është e pasqyruar në të gjitha aktet që i bashkëlidhen këtij projekti.

²⁰⁰ Në të cilin ushtrohet veprimtaria sezonale tregtare si bujtinë.

²⁰¹ Në përputhje me mundësitë e tij, parashtroi subjekti i rivlerësimit, vendosi në dispozicion të Kolegjit dokumentacionin që mundi të gjente te të afërmit e tij dhe tek ai vetë, për aq sa mendonte se do i duhej në të ardhmen, dhe në mirëbesim se shteti nuk mund të humbasë kurrë praktikën e akteve që nxjerr/miraton vetë, i cili

nga ish-komuna Margegaj janë akte të ligjshme dhe me vlerë të plotë juridike, gjë e cila vjen vetëm si rrjedhojë e ndjekjes së një procesi të rregullt, dhe nuk ka asnjë indicie që të vërtetojë që kjo leje zhvillimi dhe ndërtimi të jetë dhënë në kapërcim të kompetencës dhe/ose në shkelje të procedurës ligjore administrative. Për më tepër, sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioneri gaboi kur kërkoi para Kolegjit në seancën e datës 04.02.2020 që ai të vërtetonte se plotësonte kushtet e parashikuara nga neni 70/13 i ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009, “Për planifikimin e territorit”, pasi neni 70/13 i këtij ligji nuk është legjislacioni në fuqi në kohën e miratimit të lejes së ndërtimit, sepse leja e ndërtimit për shtëpinë në {***} ishte marrë në datën 05.03.2013, ndërsa neni 70/13 është shtuar në ligjin nr. 110, datë 01.04.2013.

34.9. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit referon në mënyrë të posaçme në shkresën nr. {***} prot., datë 17.01.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit²⁰², në aktin e ekspertimit të bërë për godinën në {***} nga eksperti privat, në kopjen origjinale personale, sipas tij të katit përdhe që në momentin e aplikimit për leje ndërtimi, dhe të administruar si provë në seancën më të fundit gjyqësore²⁰³, si dhe në CD-në që ka video të ditëve të fundit të gjendjes së godinës në {***} .

35. Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) mori në shqyrtim vendimin e Komisionit për sa i përket procesit të rivlerësimit të z. Arben Dollapaj, mbi bazën e shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik Florian Ballhysa.
36. Kolegji, në hetimin gjyqësor, administroi provat e reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj, administroi dokumentacionin shtesë të marrë nga institucionet shtetërore, në funksion të hetimit pasuror, dhe verifikoi denoncimet nga publiku.

II. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

37. Kolegji shqyrtoi çështjen gjyqësore, bazuar në aktet e administruara në dosjen e Komisionit, në aktet e depozituara në Kolegji nga subjekti i rivlerësimit dhe në dokumentet e depozituara në Kolegji në bazë të vendimit për çeljen e hetimit, pasi vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm.

A. Shtëpia e banimit në fshatin {*}, Tropojë**

38. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj ka deklaruar një shtëpi banimi në fshatin {***}, Tropojë, sipas kontratës “Akt marrëveshje për bashkinvestim, për rikonstruksion dhe bashkëpronësi” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013, për të cilën nuk kanë përfunduar akoma punimet, me vlerë²⁰⁴ 5.000.000 lekë, pa specifikuar pjesët/përqindjet, si dhe se ka likuiduar detyrime që burojnë nga kjo kontratë në shumën 2.550.000 lekë.

kishte të bënte kryesisht me anën strukturore, projektin teknik të katit përdhes dhe njëkohësisht disa projekte me natyrë teknike, si hidraulike, elektrike apo konstruksione të cilat vlerësoi se ishin të domosdoshme t'i mbante për të ardhmen, për çdo dëmtim të mundshëm në të ardhmen, dhe se nuk e kishte të mundur që të dorëzonte ndonjë dokument shtesë apo deklaratë noteriale prej arkitektit E.A., të ngarkuar nga vëllai i tij, z. Sh.D., për shkak se z. E.A. ndodhet në ShBA që prej datës 16.11.2019.

²⁰² Subjekti i rivlerësimit thekson se kopje e kësaj praktike është edhe dëshmia e penalitetit e vëllait të tij, z. Sh.D.

²⁰³ Sipas subjektit të rivlerësimit, dosje që në kapakun e saj ka të shënuar të gjitha nënshkrimet, vulat dhe komentet e institucioneve shtetërore që kërkoheshin të prononcoheshin, sipas praktikës së kohës për lejen e ndërtimit.

²⁰⁴ Nga preventivi i vitit 2010 për objektin “rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti 2 kate dhe papafingo pronare F.R.D., fshat {***}”, i preventivuesit ing. F.K., rezulton se shuma totale pas përshkrimit të punimeve është 5.882.794 lekë.

39. Nga deklarata periodike 2013, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013, për bashkinvestim dhe njohje pronësie për rikonstrukcionin e një shtëpie me sip. 88 m² në fshatin {***} , Tropojë, me znj. F.D., z. Sh. dhe znj. N.D., duke deklaruar gjithashtu se gjatë vitit 2013 nuk ka pasur efekte financiare, pasi nuk kishte filluar të paguante në lidhje me zbatimin e kushteve të kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013, ndërkohë që pjesën takuese subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar 1/4.

39.1. Ndër vite, në deklaratat periodike, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontributin në investimin e kryer për këtë pasuri, përkatësisht:

- a) në deklaratën periodike 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësime në kursimet e mëparshme, në shumën 450.000 lekë, paguar në para në dorë;
- b) në deklaratën periodike 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësime në kursimet e mëparshme, në shumën 1.150.000 lekë, pagesa është dhënë në *cash*, me këste, subjektit të deklaruar më parë; dhe
- c) në deklaratën periodike 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësime në kursimet e mëparshme, në shumën 950.000 lekë, pagesa është dhënë në *cash*, me këste, subjektit të deklaruar më parë.

40. Komisioneri kundërshtoi vendimin e Komisionit për vlerësimin e kryer për pasurinë shtëpi banimi në fshatin {***} , Tropojë, duke paraqitur pretendime për cilësimin si person tjetër të lidhur për këtë pasuri të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. Sh.D., për verifikimin e funksionit të përdorimit të ndërtesës së deklaruar si shtëpi banimi, për cilësimin si person tjetër të lidhur të motrës, znj. N.D., si dhe për përllogaritjen e shpenzimeve të tjera për godinën, në funksion të objektit të shfrytëzimit.

41. Për sa i përket pretendimit për cilësimin e personave të tjerë të lidhur të z. Sh.D. dhe znj. N.D., Kolegji konstaton se marrëdhënia e interesit të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht me vëllain dhe motrën e tij, për sa i përket kësaj pasurie, është e ndryshme nga marrëdhënia e dhurimit, huas apo huapërdorjes. Subjekti i rivlerësimit në këtë marrëdhënie interesi është bashkinvestitor, së bashku me z. Sh.D. dhe znj. N.D., sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013, në rikonstrukcionin e ndërtesës mbi trojet në pronësi të znj. F.D., sipas lejeve përkatëse të ndërtimit dhe zhvillimit, datë 05.03.2013, të lëshuara nga Komuna Margegaj, Tropojë.

41.1. Kështu, nga akt marrëveshja për bashkinvestim dhe bashkëpronësi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013, rezulton se duke qenë se pronarja, znj. F.D.²⁰⁵, ka qenë në pamundësi financiare për ta rikonstruktuar, palët kontraktore, z. Sh.D., znj. N.D. dhe z. Arben Dollapaj, kanë deklaruar se ishin dakord që të mbulonin të tre së bashku në pjesë të barabarta shumën e investimit për rikonstrukcion, merementim shtese e sistemim të pronës, në tërësi truall dhe ndërtesë, dhe njëkohësisht rezulton se znj. F.D. ishte dakord dhe se i njihte ata bashkëpronarë në truall/ndërtesë për 1/4 pjesë secili, ndërsa për 1/4 ajo mbetej bashkëpronare.

41.2. Pronësia e znj. F.D. mbi truallin dhe njësinë konfirmohet nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 09.01.2018, të ZVRPP Tropojë, nga e cila rezulton se në pronësi të znj. F.D. janë të regjistruara këto pasuri:

- a) pasuria nr. {***} zk {***}, {***} , vol. {***}, f. {***}, truall. sip. 88 m²;
- b) pasuria nr. {***} zk {***}, {***} , vol. {***}, f. {***}, truall. sip. 197 m²;
- c) pasuria nr. {***}, zk {***}, {***} , vol {***}, f. {***}, njësi. sip. 88 m².

²⁰⁵ Që është pronare e vetme e një sip. truall, ndodhur në fshatin {***} , Komuna Margegaj, Tropojë, zk {***}, nr. pas. {***} f. {***}, dhe zk {***}, nr. pas. {***}, f. {***}, , sip. e pasurive prej 285 m², mbi të cilën është ndërtuar një shtëpi banimi që nuk është në gjendje të mirë teknike.

41.3. Nga kartela e pasurisë së paluajtshme, datë 09.01.2018, të lëshuar nga ZVRPP Tropojë, rezultoi se pas. nr. {***}, zk {***}, Tropojë, {***} , truall me sip. 88 m², në pronësi të znj. F.D., në seksionin D, rezultoi të ishte shënuar “LN, datë regjistrimi 19.03.2007, trualli nr. {***} është pronë e shtetit, mbi të cilin është ndërtuar pas. nr. {***}, vol. {***}, f. {***}”, ndërkohë që nga kartela e pasurisë së paluajtshme, datë 09.01.2018, të lëshuar nga ZVRPP Tropojë, rezultoi se pasuria nr. {***}, zk {***}, Tropojë, {***} , truall, me sip. 197 m², ishte në pronësi të znj. F.D.

41.4. Nëpërmjet kontratës shitje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2007, rezultoi se z. T.M. i kishte shitur znj. F.D. pasurinë nr. {***}, të ndodhur në Tropojë, zk {***}, sip. 88 m², ndërtesë njëkatëshe me kallkan, trualli pronë e shtetit, për çmimin 700000 lekë, shumë të cilën, sipas deklaratimit të palëve kontraktore, e kishin likuiduar totalisht para përpilimit të kontratës dhe jashtë zyrës noteriale.

41.5. Subjekti i rivlerësimit parashit se nuk kishte kontribuar financiarisht për blerjen e ndërtesës në fshatin {***} , por se ishte vëllai i tij, z. Sh.D., ai që kishte ndihmuar financiarisht nënën e tij, znj. F.D., për blerjen e shtëpisë, specifikisht në shumat:

- a) 2500 euro, nëpërmjet {***}; dhe
- b) 4000 euro, nëpërmjet {***}.

41.6. Nga nxjerrja e llogarisë në euro për periudhën nga data 01.09.2005 - 27.01.2012, rezultoi se z. Sh.D., në datën 01.11.2006, kishte tërhequr shumën prej 2.500 euro, ndërkohë që në datën 29.01.2007 tërhoqi edhe shumën prej 4000 eurosh.

41.7. Znj. F.D., nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.07.2018, deklaroi se të gjitha pagesat lidhur me këtë objekt, të ndodhur në fshatin ku ishte rritur, ishin kryer nga ana e djalit të saj, z. Sh.D., me kërkesë dhe për llogari të saj, dhe se do të reflektoheshin në ndarjen/pjesëtimin e pasurisë ndërmjet fëmijëve, pasi të mbaronte rikonstrukcioni i shtëpisë. Gjithashtu, nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.07.2018, z. Sh.D. deklaroi se të gjitha pagesat që janë bërë nga ana e nënës së tij, znj. F.D., në lidhje me blerjen e shtëpisë në fshatin {***} , ishin paguar nga ana e tij, dhe për të lidhur kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.04.2011, ka qenë ai personi i autorizuar, ndërkohë që sipas tij, rikonstrukcioni i kësaj banese po vazhdon të bëhet me investimin dhe financat e tij, të motrës, znj. N.D., dhe të vëllait, z. Arben Dollapaj.

41.8. Ka rezultuar se, nëpërmjet kontratës shitje e pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.11.2008, DASHPP-ja i ka shitur znj. F.D. truallin e objektit mensë-kuzhinë, {***} , Tropojë, me sip. 88 m², nr. pas. {***}, zk {***}, për çmimin 145552 lekë, pagesa për të cilin është kryer me transfertë bankare në {***} Bank, sipas kushteve të vendosura në autorizimin për pagesë trualli nr. {***} prot., datë 27.11.2007, ndërkohë që nga veprim arke, datë 30.12.2007, pranë {***} Bank, rezultoi se znj. F.D.²⁰⁶ ka arkëtuar për llogari të DASHPP-së, për shitje trualli, shumën prej 145702 lekësh.

41.9. Nëpërmjet kontratës shitje e pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.04.2011, DASHPP-ja i ka shitur znj. F.D. truallin shtesë të objektit mensë-kuzhinë, {***} , Tropojë, me sip. 197 m², për çmimin 324065 lekë, të paguar me transfertë bankare në {***} Bank, sipas kushteve të vendosura në autorizimin për pagesë trualli nr. {***} prot., datë 24.03.2011, ndërkohë që nga njoftim/kredi datë 22.04.2011, pranë {***} Bank, rezultoi se nga znj. F.D. është derdhur shuma prej 324065 lekësh, për pagesë trualli të objektit mensë-kuzhinë {***} ²⁰⁷.

²⁰⁶ Te rubrika “klienti”, me shkrim dore është shkruar emri “F.D.”, së bashku me nënshkrimin përkatës.

²⁰⁷ Nga ku citohet edhe fatura nr. {***}, datë 24.03.2011.

41.10. Znj. F.D., nëpërmjet prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.04.2011, rezultoi të kishte autorizuar z. Sh.D. për ta përfaqësuar në çdo institucion shtetëror, zyrë vendore, zyrë noteriale, zyrë të gjendjes civile, bashki, komunë apo të tjera, ku të paraqiste dhe të tërhiqte dokumentacionin, të aplikonte, të nënshkruante kërkesa, ankesa, kontratë shitblerjeje me cilësinë e palës shitëse si pronare e objektit me emërtimin mensë-kuzhinë në {***}, Tropojë, në bazë të kontratës së shitjes së objektit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.10.2010, nga DASHPP-ja²⁰⁸.

41.11. Komuna Margegaj, Tropojë, me lejen e zhvillimit nr. ska prot., datë 05.03.2013, dhe lejen e ndërtimit nr. s'ka prot., datë 05.03.2013, rezultoi t'i ketë dhënë zhvilluesit, znj. F.D., njëkohësisht leje zhvillimi dhe ndërtimi për punimet "rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti 2 kate dhe papafingo, fshati {***} , Komuna Margegaj, rrethi Tropojë".

41.12. Sipas preventivit të vitit 2010 për objektin "rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti 2 kate dhe papafingo, pronare znj. F.R.D., fshati {***} ", të preventivuesit ing. F.K., rezulton se shuma totale pas përshkrimit të punimeve, është 5882794 lekë.

42. Duke i shqyrtuar në tërësi rrethanat e faktit për fitimin e pronësisë nga znj. F.D. në raport me pasurinë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si "shtëpi banimi në fshatin {***} /Tropojë", dhe në vijim rikonstruksionin bashkërisht nga z. Sh.D., znj. N.D. dhe subjekti i rivlerësimit, të ndërtesës mbi trojet po në pronësi të znj. F.D., nuk ka rezultuar që z. Sh.D. dhe znj. N.D. t'i kenë dhuruar apo dhënë hua subjektit të rivlerësimit qoftë me qëllim financimin për blerjen e kësaj pasurie apo edhe rikonstruksionin në vijim të ndërtesës.

43. Në referim të jurisprudencës së Kolegjit, persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, do të konsiderohen ata persona që kanë me subjektin një marrëdhënie huaje apo dhurimi, sipas parashikimit të kësaj dispozite, dhe çdo person i cili ka me subjektin një marrëdhënie interesi në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, do të jetë një person tjetër i lidhur sipas nenit 32, pika 4 e këtij ligji, por vetëm ata persona që gjenden me subjektin në marrëdhëniet e parashikuara nga kjo dispozitë ligjore.

43.1. Në analizë të kësaj situate ligjore²⁰⁹, Kolegji çmon se përcaktimet e nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 shërbejnë për të përcaktuar rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit në kontekst më të gjerë, si në funksion të deklarimit e verifikimit të çdo situate të mundshme të konfliktit të interesit, pjesë gjithashtu e detyrueshme për kontroll si nga ILDKPKI-ja²¹⁰, ashtu edhe nga vetë organet e rivlerësimit, edhe në funksion të përcaktimit të detyrimit të subjekteve të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Përfshirja e një individi të caktuar në rrethin e personave të tjerë të lidhur, sipas përcaktimit të nenit 3, pika 14, krijon për subjektin e rivlerësimit dy konsekuenca ligjore: së pari, të provojë se nuk ekziston ndonjë situatë e konfliktit të interesit me këta persona, në kuptim të parashikimeve të legjislationit të posaçëm që rregullon këtë fushë²¹¹ dhe, së dyti, të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij, kur plotësohen kërkesat e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Ky detyrim i subjektit të rivlerësimit rezulton i qartë, përcaktuar në rrethana të veçanta, kur këta persona të tjerë të lidhur të kenë si elemente të detyrueshme në marrëdhënien me subjektin e rivlerësimit një marrëdhënie huaje apo dhurimi, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Pra, në këndvështrim të Kolegjit, një

²⁰⁸ E cila me shkresën nr. {***}, datë 24.03.2011, kishte dhënë autorizim për t'i shitur truallin shtesë funksional me sip. 197 m², rreth objektit të sipërpërmendur.

²⁰⁹ Shih pikën 109 të vendimit nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

²¹⁰ Shih nenin 33, pika 5, shkronja "d" e ligjit nr. 84/2016.

²¹¹ Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale.

subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave.

44. Për sa i përket pretendimit të Komisionerit për funksionin e ndërtesës, Kolegji vëren se subjekti e ka deklaruar si “shtëpi banimi”, ndërkohë që nga aktet e administruara në dosje, kjo pasuri rezulton të jetë pjesë e pandarë e një njësie shërbimi, në të cilën ushtrohet aktivitet tregtar, hoteleri/bujtinë.

44.1. Nga shkresa nr. {***} prot., datë 06.02.2018, e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (në vijim “OShEE”), ndër të tjera, rezultoi se për abonentin, z. Sh.D., me nr. kontrate {***}, me NUIS {***}, aktivitet privat në fshatin {***}, Tropojë, kontrata për furnizimin me energji elektrike ishte hapur në datën 29.09.2017 dhe vijonte të ishte ende aktive.

44.2. Në faqen zyrtare të QKB-së, në regjistrin tregtar, në datën 27.07.2016, me NUIS {***}, rezultoi i regjistruar subjekti tregtar Sh.D., person fizik, me fushë veprimtarie “dhoma për fjetje bujtinë”, me vend ushtrimi aktiviteti në Kukës, Margegaj, {***}, Lagjja Qendër {***}, rr. “{***}”, objekti nr. {***}, zk {***}, nr. pas. {***}, statusi i të cilit ishte aktiv²¹².

44.3. Pas çeljes së hetimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegj ekstraktin historik të QKB-së dhe certifikatën e regjistrimit, datë 25.11.2019, për subjektin tregtar Sh.D. person fizik²¹³, nga ku nuk rezulton që objekti i ushtrimit të veprimtarisë të jetë ndarë nga pjesa e tij, por se vendi i ushtrimit të aktivitetit përfaqësohet nga pasuria nr. {***}, në tërësinë e saj. Gjithashtu, nëpërmjet dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në vijim të gjyqimit të çështjes, sikurse derdhja për thesarin e {***} Bank. datë 04.12.2013, si dhe dokumentet teknike, si: plani i lidhjes së strukturës me infrastrukturën, plani i katit të parë, impianti i furnizimit me ujë sanitar, impianti i mbrojtjes kundër zjarrit, impianti i shkarkimit të ujërave të zeza, hollësi të armimit të travetave me polisterol, detaje të lidhjes së hekurit, armimi i plintit dhe armimi i kolonës²¹⁴, nuk u arrit të provohet destinimi i ndryshëm i objektit nga objekti i veprimtarisë tregtare hoteleri/turizëm, dhoma për fjetje bujtinë, në tërësinë e tij.

45. Për sa i përket pretendimit të Komisionerit për përlllogaritjen e shpenzimeve të tjera për godinën, në funksion të shfrytëzimit të objektit, Kolegji vëren se ka mospërputhje midis asaj çka ka deklaruar subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj, si pasuri, por edhe midis vlerave që rezultojnë nga deklarata *vetting* dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes para Komisionit dhe Kolegjit, ndërkohë që nuk rezulton asnjë vlerë e deklaruar për shpenzime të tjera, sikurse, mobilim.

45.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një shtëpi banimi në fshatin {***}, Tropojë, sipas kontratës “Akt marrëveshje për bashkinvestim (për rikonstruksion dhe bashkëpronësi)” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013, për të cilën nuk kishin përfunduar akoma punimet, me vlerë 5.000.000 lekë (vlerë jopërfundimtare), dhe se nuk ishin specifikuar përqindjet për pjesën takuese²¹⁵.

²¹² Aktiviteti tregtar nga ky subjekt është ushtruar me periudha, pasi: a) është pezulluar në datën 14.02.2017 dhe ka rifilluar në datën 19.07.2017; b) është pezulluar në datën 26.10.2017 dhe ka rifilluar në datën 23.05.2018; dhe c) është pezulluar në datën 18.10.2018 dhe ka rifilluar në datën 14.05.2019.

²¹³ NUIS {***}, fusha e veprimtarisë “dhoma për fjetje bujtinë” dhe vend ushtrimi aktiviteti “Kukës, Margegaj, {***}, Lagjja Qendër {***}, rr. “{***}”, objekti nr. {***}, zk {***}, nr. pas. {***}”.

²¹⁴ Shih paragrafin 32, më sipër.

²¹⁵ Ka diferencë në deklarime, pasi subjekti në *vetting* ka deklaruar vlerën “5.000.000 lekë (vlerë jopërfundimtare)” dhe në pjesën “Detyrime” ka deklaruar “Likuidim të detyrimeve që burojnë nga kontrata me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013, për rikonstruksionin e një shtëpie në fshatin {***}, ku nuk kanë

45.2. Nga preventivi i vitit 2010 për objektin “rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti 2 kate dhe papafingo, pronare F.R.D., fshat {***}”, të inxhinierit F.K., rezultoi se shuma totale pas përshkrimit të punimeve ishte 5.882.794 lekë, me TVSh, dhe 4.902.328 lekë, pa e përfshirë TVSh-në.

45.3. Sipas aktit të ekspertimit të inxhinierit M.C., të shtëpisë në {***}, për pjesën takuese të z. Arben Dollapaj, shuma totale e pretenduar e pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit, prej 52,5 m²,²¹⁶ ishte 4.219.140 lekë me TVSh, dhe 3.515.950 lekë, pa e përfshirë TVSh-në.

46. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka deklaruar vetëm pjesën takuese, bie ndesh me preventivin e vitit 2010 për objektin “rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti 2 kate dhe papafingo, pronare F.R.D., fshati {***}”, të inxhinierit F.K., pasi përshkrimi i punimeve nuk është i kufizuar vetëm në pjesën e veçuar të ndërtesës, si pjesë takuese e pretenduar, por për të gjithë objektin, duke mos shpjeguar bindshëm vlerën e totalit të investimit, ashtu dhe vlerën e investimit për pjesën takuese të tij në këtë ndërtesë, për sa i përket sipërfaqes totale apo numrit të kateve që ai posedon në këtë ndërtesë²¹⁷.

46.1. Shprehimisht, tek analiza e përshkrimit të punimeve, sipas preventivit të vitit 2010 të inxhinierit F.K., punimet e betonit e betonit arme, përshkruhen si: “262/2, punime betoni për gjithë objektin”. Gjithashtu në këtë preventiv, njëtrajtësisht ishin preventivuar për të gjithë objektin, “punimet e muraturës”, “punimet e shtresës e veshje”, “punimet e suvatimit e bojatisjes”, “punimet e hidroizolimit”, “punimet e dyer/dritareve”, “punimet e instalimit”, “punimet e hidrosanitareve” dhe “punimet e ngrohjes”.

46.2. Kolegji vëren se znj. F.D., pronësinë mbi truallin shtesë funksional të objektit mensë-kuzhinë, {***}, Tropojë, prej 197 m², e ka fituar pas preventivit të vitit 2010, të inxhinierit F. K., nëpërmjet kontratës shitje e pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.04.2011. Në akt marrëveshjen për bashkinvestim dhe bashkëpronësi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.01.2013, nga ana tjetër, rezulton të jetë përfshirë në zhvillim sipërfaqja totale e truallit prej 285 m². Për këtë arsye, preventivi i vitit 2010 për objektin “rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti 2 kate dhe papafingo, pronare F.R.D., fshati {***}”, i preventivuesit, ing. F.K., nuk përfaqëson vlerën e plotë dhe të saktë të investimit të sipërfaqes ndërtimore.

47. Për sa më sipër, me të drejtë, Komisioneri ka pretenduar se për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte vlerën e totalit të investimit, ashtu dhe vlerën e investimit për pjesën takuese të tij në këtë ndërtesë, për sa i përket sipërfaqes totale apo numrit të kateve që ai posedon në këtë ndërtesë dhe se kishte kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me gjendjen faktike të kësaj pasurie, pasi ishte regjistruar pranë QKB-së në datën 27.07.2016, si sipërmarrje private.

48. Në të kundërt me sa pretendon subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj, se nuk ka asnjë indicie që të vërtetojë se leja e zhvillimit e datës 05.03.2013 dhe leja e ndërtimit e datës 05.03.2013 të

përfunduar akoma punimet. Shuma 2.550.000 lekë”, pra del se është paguar shuma prej 2.450.000 lekësh. Ndërkohë, sipas deklarameve në deklaramat periodike 2014, 2015 dhe 2016, ka deklaruar se ka paguar shumën 2.550.000 lekë (në 2014 - 450.000 lekë, në 2015 - 1.150.000 lekë dhe në 2016 - 950.000 lekë), ndryshe nga sa më sipër (për një diferencë prej 100.000 lekësh), si dhe në deklaramtën periodike 2016 ka deklaruar se kanë “mbetur për t’u shlyer 2.550.000 lekë”, pra në total vlera e investuar sipas deklarameve vjetore del 5.100.000 lekë (ndryshon me 100.000 lekë nga ajo e deklaruar në vetting, prej 5.000.000 lekësh).

²¹⁶ Që inxhinierit M.C. i rezultuan nga matjet në vend, pasi kishte zbërthyer volumet e ndërtimit sipas normave teknike, për punime dheu, punime murature, punime betoni dhe b/a, punime hekur betoni, punime h/izolimi dhe çatie, punime shtresash, punime tavani e suvatimi, punime suvatimi e veshje me pllaka, punime elektrike, punime h/sanitare, punime kanalizimi.

²¹⁷ Shih paragrafët 46.2 dhe 47, më poshtë.

jenë dhënë në kapërcim të kompetencës dhe/ose në shkelje të procedurës ligjore administrative, bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nëse subjekti i rivlerësimit ishte në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikonte ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetonte institucionit të rivlerësimit se dokumenti ishte zhdukur, kishte humbur, nuk mund të bëhej përsëri ose nuk merrej në rrugë tjetër.

49. Në çdo rast, bazuar në nenin Ç, pika 5 dhe në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e pretendimeve të ngritura ndaj tij

49.1. Krahas praktikës administrative së dhënies së një leje zhvillimore dhe ndërtimi, për të cilën u vërtetua mungesa e dokumentacionit nga Bashkia Tropojë²¹⁸, investitori vetë është i detyruar të vendosë detyrimisht mbikëqyrësin e punimeve, të pajisur me licencën përkatëse, i cili për llogari të investitorit, është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, dhe të kontrollojë librin e kantierit, si dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit, sipas parashikimit të nenit 7 të ligjit nr. nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (në vijim “ligji nr. 8402/1998”).

49.2. Gjithashtu, bazuar në pikën 5.1 të udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të Këshillit të Ministrave (në vijim “udhëzimi i KM-së nr. 3/2001”): “Investitori, drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi mbajnë përgjegjësi ligjore për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt, të përcaktuar në pikën 5 të këtij udhëzimi”²¹⁹.

50. E thënë ndryshe, investitori është bashkërisht përgjegjës me drejtuesin teknik dhe mbikëqyrësin e punimeve për mbajtjen në objekt të dokumentacionit tekniko-ligjor në lidhje me ndërtimin e objektit.

50.1. Për këtë arsye, nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk e kishte të mundur që të dorëzonte ndonjë dokument shtesë apo deklaratë noteriale prej arkitektit E.A., të ngarkuar nga vëllai i tij, z. Sh.D., me arsyetimin se z. E.A. ndodhet në ShBA që në datën 16.11.2019.

51. Për më tepër, nga praktika e ardhur në Kolegj me shkresën nr. {***} prot., datë 30.12.2019, të ASHK Tropojë, nuk ka rezultuar që leja e ndërtimit dhe/ose leja e zhvillimit të jenë regjistruar në zyrën kompetente të regjistrimit, sipas parashikimit të nenit 46, pika 1 e ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (në vijim “ligji nr. 33/2012”)²²⁰.

²¹⁸ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 27.12.2019, të Bashkisë Tropojë, si dhe shkresën nr. {***} prot., datë 10.01.2020, të Bashkisë Tropojë

²¹⁹ Sipas pikës 5 të udhëzimit të KM-së nr. 3/2001: “5. Në çastin e fillimit të punimeve, mbikëqyrësi duhet të bëjë verifikimet paraprake, si më poshtë vijojnë: a) Verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat, sipas dispozitave në fuqi, duhet të merren para fillimit të punimeve. b) Verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet. c) Njohjen me hollësi të kontratës së sipërmarrjes dhe e të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës. 9) Vendosijen e tabelës së identifikimit me të dhënat e mëposhtme: emërtimi i objektit; data e marrjes së lejes së ndërtimit; investitori; projektuesi; sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik; mbikëqyrësi; afati i ndërtimit; sipërfaqja e ndërtimit; lartësia (numri i kateve mbi dhe nëntokë); intensiteti sizmik i sheshit të ndërtimit, në bazë të studimit sizmologjik dhe mikrozonimit sizmik. Për objektet mbi 8 kate, të dhënat e studimeve inxhiniero-sizmologjike, të marra nga Instituti i Sizmologjisë”.

²²⁰ Sipas nenit 46, pika 1 të ligjit nr. 33/2012: “1. Leja e ndërtimit dhe/ose leja e zhvillimit, e lëshuar nga autoriteti përgjegjës, përcillet për regjistrim nga organet e pushtetit vendor në zyrën përkatëse vendore të

52. Për sa më sipër u arsyetua, Kolegji vlerëson se, për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* në mënyrë të plotë dhe të saktë vlerën e investimit të sipërfaqes ndërtimore dhe destinacionin, duke u ndodhur në kushtet e deklarimit të paplotë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, sipas përcaktimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës.

B. Shtëpia e banimit me sipërfaqe ndërtimi 113 m², në Tiranë

53. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj ka deklaruar një shtëpi banimi me sipërfaqe ndërtimi 113 m², sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.03.2011, me adresë në Njësinë Administrative Nr. {***}, rr. “{***}”, {***}, nr. {***}, Tiranë, me vlerë 9.000.000 lekë, dhe me 20% pjesë takuese, burimi i krijimit nuk është deklaruar.
54. Nga deklarata periodike 2011, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar blerjen e një sipërfaqeje banimi prej 1/2 e 113 m² dhe të sipërfaqes tokë, truall prej 157 m², shtëpi private në rr. “{***}”, {***}, Tiranë, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.03.2011, me vlerë 9.000.000 lekë dhe me pjesë takuese 100%, burimi i krijimit të pasurisë është deklaruar: (i) kursime personale 1.500.000 lekë; (ii) kredi në shumën 5.000.000 lekë; (iii) hua në shumën 25.000 USD, që në kontratë është konvertuar në lekë (të shpjeguar më parë).
- 54.1. Gjithashtu, nga deklarata periodike 2007, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar një shtesë kati me sipërfaqe 113 m², në banesën e vëllait të tij, z. Sh.D., banesë e papërfunduar në rr. “{***}”, {***}, Tiranë, me vlerë 1.700.000 lekë, dhe me pjesë takuese 100%²²¹.
55. Nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.2.2011, z. Sh.D. i ka shitur z. Arben Dollapaj 1/2 të sipërfaqes së ndërtimit prej 113 m² dhe të sipërfaqes së truallit prej 157 m², me adresë: rr. “{***}”, {***}, zk {***}, nr. pas. {***}, vol. {***}, f. {***}, të regjistruar në ZVRPP Tiranë, sipas vërtetimit hipotekor nr. {***}, datë 20.07.2004²²², për çmimin e shitjes 9.000.000 lekë, shumë e cila ishte parashikuar për t’u shlyer si më poshtë:
- a) 1.500.000 lekë, me para në dorë, dhe burim nga kursimet e blerësit;
 - b) 2.500.000 lekë, pasi blerësi kishte marrë hua; dhe
 - c) 5.000.000 lekë, me kredinë që do të merrej nga {***}-ja.
56. Drejtoria e ALUIZN-it Tiranë, në vijim të vetëdeklarimit për legalizimin e shtesës nr. {***} prot., datë 11.11.2006²²³, miratoi lejen e legalizimit nr. {***}, datë 11.07.2012, për objektin, shtesë 1 kat banim në objektin ekzistues 2 kate, nëpërmjet së cilës i jepej titulli i pronësisë z. Arben Dollapaj dhe z. Sh.D., për objektin në zk {***}, pasuria nr. {***}, sipërfaqja e ndërtimit të shtesës 128,43 m².²²⁴

56.1. Nga kartela e pasurisë së paluajtshme e datës 22.01.2018, e lëshuar nga ZVRPP Tiranë, rezultoi se për pasurinë me vol. {***}, f. {***}, zk {***}, nr. {***}, me adresë në Tiranë, me ref. {***}, ishte regjistruar sipërfaqja e truallit 270 m², sipërfaqja e ndërtesës 125,00 m², dhe

regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Regjistruesi bën regjistrimin e lejes së ndërtimit në një regjister të veçantë, të ndryshëm nga ai ku është kryer regjistrimi i truallit, por duke kryer lidhjen me truallin, i cili përbën sheshin e ndërtimit, për të cilin është lëshuar leja e ndërtimit”.

²²¹ Në këtë deklaratë vjetore, deklarohet “pakësim i gjendjes kesh të deklaruar më parë i përdorur për ndërtimin e katit të 3të, për 1,250,000 Lekë.”.

²²² Objekti i shitblerjes rezultoi të ketë qenë kati përdhes i shtëpisë dykatëshe dhe sipërfaqja e truallit 78,2 m², me emërtim apartament banimi.

²²³ Shih vetëdeklarimin për legalizimin e shtesës nr. {***} prot., datë 11.11.2006, drejtuar Njësisë së Urbanistikës së Njësisë së Qeverisjes Vendore 5, të investitorit z. Arben Dollapaj.

²²⁴ Mbi tokën e vërtetuar nga dokumenti hipotekor nr. pas. {***} vol. {***}, f. {***}, data 11.04.2011.

me ref. {***} ishte regjistruar sipërfaqja e truallit 274,42 m², sipërfaqja e ndërtesës 118,14 m², me pronarë z. Arben Dollapaj dhe z. Sh.D., me shënimin {***} “leje legalizimi”.

56.2. Nga vërtetimi, datë 11.04.2011, i lëshuar nga ZVRPP Tiranë, rezultoi se në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 07.04.2011, figuronte e regjistruar në bashkëpronësi me 1/2 të z. Arben Dollapaj dhe të z. Sh.D., pas. nr. {***}, zk {***}, sip. 270 m², sipërfaqja ndërtimore 113 m², një shtëpi dykatëshe e ndodhur në Tiranë, rr. “{***}”, me sipërfaqe ndërtimi 113 m², e përbërë në katin përdhes, nga një sallon, tri dhoma, banjo, dy veranda, dhe katin e parë përbëhet nga një sallon, tri dhoma, dy veranda dhe një ballkon, me sipërfaqe trualli 270 m². Gjithashtu, nga vërtetimi i datës 16.08.2012, i lëshuar nga ZVRPP Tiranë, rezultoi se në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 30.07.2012, figuronte e regjistruar në bashkëpronësi me 1/2 të z. Arben Dollapaj dhe të z. Sh.D., pasuria nr. {***}, zk {***}, sip. 270 m², shtesë kati mbi objekt ekzistues dy kate, me sipërfaqe ndërtimi 113 m², e përbërë në katin përdhes nga një sallon, tri dhoma, banjo, dy veranda, e përbërë në katin e parë nga një sallon, tri dhoma, dy veranda, ballkon, kati i dytë me sipërfaqe 128,43 m², ndërsa trualli me sipërfaqe 270 m².

56.3. Nëpërmjet deklaratës para noterit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.11.2006, z. Sh.D. kishte deklaruar se kati i 3-të i shtëpisë që do të ndërtohej me sipërfaqen e ndërtimit prej 113 m², ambient banimi, do të ishte në bashkëpronësi të nënës, znj. F.D. dhe z. Arben Dollapaj. Gjithashtu, z. Sh.D., nëpërmjet deklaratës para noterit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2011, kishte konfirmuar që kati shtesë mbi shtëpinë e tij ekzistuese ishte bërë me lejen e tij, se ishte bashkinvestitor dhe se ishte dakord të bëhej legalizimi i saj.

57. Kolegji, vëren se subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj, në deklaratën *vetting* ka deklaruar vlerën e kësaj pasurie prej 9000000 lekësh, dhe se burimi i kësaj vlere rezulton nga kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.02.2011, përkatësisht nga kursimet e subjektit të rivlerësimit për këstin e parë prej 1.500.000 lekësh nga huaja²²⁵, për këstin e dytë prej 2.500.000 lekësh dhe kredia nga {***}-ja për këstin e tretë prej 5.000.000 lekësh.

58. Për sa i përket pretendimit të Komisionerit për mungesë të burimeve të ligjshme për justifikimin e huas prej 25.000 USD nga kunati, z. H.S., pasi sipas Komisionerit provat dhe aktet e paraqitura nuk konsiderohen si dokumentacion justifikues ligjor, nga deklarata periodike 2010, rezulton e faktuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e borxhit/huas pa interes, në vlerën prej 25.000 USD, për blerjen e një banese nga z. H.S., kunati, para të cilat i janë transferuar nga ShBA në datën 29.04.2010, në Bankën {***}, në nr. e llogarisë së tij {***}, dhe se kjo sasi parash është dhënë si parapagesë për blerjen e një pjese të shtëpisë së vëllait të tij, z. Sh.D.

58.1. Nga shkresa/deklarata e thjeshtë, e përcjellë në Komision nga ILDPKI-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 11.07.2018, rezulton se z. H.S. kishte deklaruar se i kishte dhënë borxh kunatit të tij, z. Arben Dollapaj, 25.000 USD, pa interes, për blerjen e shtëpisë, hua e cila i ishte kthyer si më poshtë:

- a) në muajin mars të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit i kishte shlyer 20.000 USD, duke i derdhur në llogari bankare; dhe
- b) në datën 12.10.2013, ia ka dhënë *cash* edhe 5.000 USD, të pjesës së mbetur.

58.2. Rezulton e provuar nga nxjerrje llogarie e {***} Bank, se në llogarinë nr. {***} të z. Arben Dollapaj, në datën 05.05.2010, është derdhur shuma prej 24.956,47 USD, me përshkrimin: “transfertë nga banka të tjera {***}”. Nga e njëjta llogari bankare, në datën 30.03.2012, nga z. Arben Dollapaj është transferuar shuma prej 20.000 USD në favor të përfituesit, z. H.S., me përshkrimin “personal debt”. Gjithashtu, në deklaratën periodike vjetore

²²⁵ Nga kunati, z. H.S.

2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka shlyer 5000 USD, pagesë e cila është dhënë në *cash* dhe, sipas deklarimit në deklaratën periodike, me këtë pagesë të fundit ishte shlyer i gjithë detyrimi.

59. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të vërtetojë bindshëm, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, se z. H.S. kishte mundësi për të dhënë hua shumë prej 25000 USD²²⁶, pasi dokumentet e paraqitura në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj, për të dhënat pasurore të z. H.S., u përkisnin periudhave të ndryshme kohore nga periudha e marrjes së huas²²⁷. Gjithashtu, dokumentet e tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, sikurse shkrimet në gazetën “{***}”, datë 01.07.2014, dhe *website* të ndryshme, interesat që z. H.S. ka në disa shoqëri ndërtuese, ekstrakti tregtar i shoqërisë “{***}”, marrëveshja përmblyëse për kontratën e huas ndërmjet “{***}” dhe “USA Pennsylvania”, për shumë 1.100.000 USD dhe letra e angazhimit no. {***}, datë 29.05.2009, deklarata e shlyerjes së vitit 02.05.2010 në vlerën 450.000 USD, formulari i deklaratës së të ardhurave të ortakërisë për vitin 2018 me total asetesh 3.582.129 USD, si dhe pasqyra financiare e Bankës {***} për periudhën 08.01.2014 - 29.08.2014, me gjendje 2.164.254,83 USD, dëshmojnë për veprimtari ekonomike të z. H.S., të shtrira në kohë, por pa vërtetuar shlyerjen e detyrimeve tatimore të personit juridik, pronar i të cilit është kunati, z. H.S. dhe, si pasojë, provueshmërinë e burimeve të ligjshme të këtij të fundit në momentin e dhënies së huas.
60. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* shtesën e katit të deklaruar në deklaratën periodike 2007, me sipërfaqe 113 m², në banesën e vëllait të tij, z. Sh.D., banesë e papërfunduar në rr. “{***}”, {***}, Tiranë, me vlerë 1.700.000 lekë dhe pjesë takuese 100%.
- 60.1. Nga vërtetimi i datës 16.08.2012, i lëshuar nga ZVRPP Tiranë, rezulton se kjo pasuri figuron e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 30.07.2012, në bashkëpronësi me 1/2 të z. Arben Dollapaj dhe të z. Sh.D., pas. nr. {***}, zk {***}, sip 270 m², shtesë kati mbi objekt ekzistues dy kate, sip. ndërtimi 113 m², të përbërë në katin përdhes nga një sallon, tri dhoma, banjo, dy veranda, në katin e parë nga një sallon, tri dhoma, dy veranda, ballkon, kati i dytë me sip. 128,43 m², trualli me sip. 270 m².
61. Për sa i përket pretendimit të Komisionerit për burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e shtesës së katit me sipërfaqe 113 m², në vlerën 1.700.000 lekë që, sipas Komisionerit, ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme në shumë 810.767 lekë, Kolegji konstaton se, në ndryshim me Komisionerin, referuar pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në parashtrimet e paraqitura në seancën publike, datë 04.12.2019, për analizën financiare të bërë nga Komisioneri për vitin 2007, subjektit të rivlerësimit i rezulton diferencë negative në shumë 10.756 Lekë. Kjo llogaritje e subjektit të rivlerësimit vjen si kombinim i llogaritjes: a) më pak të ardhurave për shumë 718.012 lekë; dhe b) më shumë të shpenzimeve për shumë 82.000 lekë.

²²⁶ Nga llogaria e subjektit në {***} Bank rezulton se dërgimi i fondeve të deklaruara në datën 29.04.2010, duket se është bërë nga kompania “{***}” si urdhërues sipas përshkrimeve në lëvizjen e llogarisë bankare të subjektit, jo nga individ, z. H.S., si deklaruar nga subjekti, dhe pagesa nga subjekti sipas SWIFT dhe lëvizjeve të llogarisë i është bërë z. H.S. si individ, me përshkrimin “personal debt”, pra fondet vijnë nga kompania dhe jo individ.

²²⁷ Sikurse subjekti i rivlerësimit ka renditur si prova informacionin individual për të ardhurat vjetore të kunatit, z. H.S., dhe bashkëshortes së tij, znj. N.R., viti 2018, pasqyrën financiare të Bankës {***} në emër të z. H.S., sipas së cilës bilanci përmblyës për periudhën 08.01.2014 - 29.08.2014, gjendja në llogarinë e tij bankare ishte në shumë 2.164.254,83 USD, apo formulari i deklaratës së të ardhurave të ortakërisë, që relatton të ardhura nga aktiviteti i qiradhënies për vitin 2018, me anë të të cilit vërtetohet totali i asetëve për shumë 3.582.129 USD.

a) Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat janë përlogaritur më pak si shumë totale e të ardhurave nga pagat, të konsideruara më pak prej 92.362 lekësh, të pretendimit të konsiderimit të dhurimit prej motrave në shumën 4000 USD si e ardhur në 2007 dhe mospërfshirjes së të ardhurës nga dhurimi i motrës, znj. D.N., prej 3.000 USD në dhjetor 2007, nga të cilat Kolegji vëren se:

- Të ardhurat nga pagat e tij janë përlogaritur më pak, në shumën 92.362 lekë, kjo pasi siç shprehet në periudhën e deklaramit vjetor, vërtetimet janë marrë nga i njëjti institucion, por gjatë deklaramit vjetor, përveç pagës neto, janë përfshirë edhe *dietat dhe shpërblimet gjatë vitit e fundvitit etj.*, gjë e cila nuk është reflektuar në vërtetimet e rimarra nga institucionet në momentin e plotësimit të dokumentacionit për rivlerësim. Konstatohet se Komisioneri në analizë dhe Komisioni është u janë referuar vërtetimeve të institucioneve, sjellë gjatë procesit *vetting*, ku janë konsideruar të ardhurat neto, dorëzuar nga subjekti së bashku me deklaratën *vetting* dhe deklaruar në të nga subjekti në po të njëjtat shuma. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka ankimuar këtë diferencë në Komision, në përgjigje të rezultateve hetimore. Gjithashtu, sipas jurisprudencave²²⁸ të mëparshme në Kolegji, dietat nuk përfshihen në të ardhurat e vitit, pasi ato janë marrë dhe përdorur për një qëllim specifik. Pra, duket se nuk qëndron ky pretendim i subjektit.
- Subjekti pretendon se dhurimin nga motrat (katër motra), gjatë vizitës së tij në ShBA, në muajt dhjetor 2006 - janar 2007, në shumën 4.000 USD, e konvertuar në lekë 376.560 lekë, janë të ardhura në vitin 2007, jo në vitin 2006. Këto të ardhura janë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2006, *pasi ato janë dhuruar në muajin dhjetor të vitit 2006, por në fakt ato janë arkëtime të cilat janë bërë hyrje në vitin 2007 dhe e pretendon si të ardhur në analizën e vitit 2007. Më tej, subjekti i rivlerësimit thekson se këto të ardhura të deklaruara në vitin 2006, por të përdorura në vitin 2007, nuk përbëjnë ndryshim në analizën financiare të vitit 2006, pasi për aq sa rriten të ardhurat nga dhuratat, po për të njëjtën vlerë rritet gjendja monetare cash në banesë. Duket se nuk qëndron shpjegimi i subjektit të rivlerësimit, pasi momenti i dhurimit dhe i arkëtimit për dhuratën është në të njëjtën kohë, duket se ka qëndrime të ndryshme në analizën e vitit 2006 në parashtrime dhe atë të vitit 2007²²⁹, nuk e përcakton fakti se këto të ardhura kanë hyrë në Shqipëri në vitin 2007, se janë të ardhura të vitit 2007. Më tej, subjekti pretendon se ato nuk do ndikonin në analizën e vitit 2006 pasi do ishin të ardhura, por në të njëjtën kohë dhe rritje e gjendjes *cash*, pra se kanë kontribuar në rritjen e gjendjes *cash* të deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike 2006 (prej 750.000 lekësh) e më tej në shpjegime, subjekti deklaroi se është përdorur për ndërtimin e shtesës, për të cilën ka deklaruar në deklaratën periodike 2007 se ka përdorur kursime të mëparshme (pra, siç është shprehur më sipër, ka përdorur dhe dhurimin e pretenduar që ka rritur *cash* në 2006), të cilat janë përfshirë në analizën financiare të Komisionerit si përdorim i gjendjes *cash* për shtesën e katit prej 1.250.000 lekësh. Për më tepër që subjekti vetë e ka deklaruar si dhurim në deklaratën periodike 2006. Pra, nuk qëndron pretendimi i subjektit se kjo e ardhur duhet llogaritur në analizën e vitit 2007.*

b) Subjekti pretendon se janë konsideruar shpenzime të shkollimit të djalit të tij (me datëlindje 23.02.2002), por janë shpenzime të cilat kanë filluar në vitin 2008, pasi në vitin 2007 ai ka qenë 5 vjeç dhe nuk ka qenë në shkollë (por në kopshtin nr. {***}, Tiranë), e ndërsa si shpenzime udhëtimi gjatë këtij viti, ka pasur një udhëtim me kolektivin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në Egjipt, me paketë turistike në shumën 500 euro (konvertuar në 60.890 lekë).

²²⁸ Shih paragrafët 34-36 të vendimit nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

²²⁹ Citim: “Kjo shumë nga unë është deklaruar si e ardhur në vitin 2006, ndoshta duke iu referuar faktit se më është dhënë nga motrat në muajin dhjetor, por në fakt kjo shumë është bërë hyrje në Shqipëri në muajin janar”.

Pra, dhe sikur të konsideroheshin pretendimet e subjektit, përveç atyre trajtuar më lart, të cilat nuk qëndrojnë, si dhe duke konsideruar se vlera e investimit ka rezultuar më e lartë (trajtuar në vijim) nga sa ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2007, qëndron pretendimi i Komisionerit se subjekti do të ishte me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e shtesës së katit me sipërfaqe 113 m².

61.1. Kolegji vëren se, përveç se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* pronësinë mbi shtesën e katit të dytë, nga hetimi i kryer në Kolegji, ka rezultuar një vlerë investimi më e madhe nga vlera e deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2007.

61.2. Kështu, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në datën 16.02.2011, ka paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë, në shumën prej 18.194 lekësh, për investimin e kryer në vlerën 3.638.807,19 lekë²³⁰.

62. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se kredia me kushte lehtësuese ka qenë pikërisht për t'i mundësuar strehimin atij dhe të familjes në katin e dytë të shtëpisë së vëllait, z. Sh.D., që në atë kohë nuk ka qenë e gatshme për banim, duke theksuar se taksa e ndikimit në infrastrukturë në datën 03.03.2011, nuk ka asnjë lidhje ligjore me përfundimin ose jo të punimeve të ndërtimit, Kolegji vlerëson fillimisht të renditë kronologjikisht faktet si më poshtë.

62.1. Nëpërmjet vetë vetëdeklarimit për legalizimin e shtesës nr. {***} prot., datë 11.11.2006, subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e investitorit, shprehimisht ka deklaruar objektin “Shtesë kati për banim”²³¹ dhe se: “Është ngritur kat shtesë mbi shtëpinë ekzistuese”.

62.2. Në deklaratën periodike 2007, te pjesa e përshkrimit të pasurive, subjekti i rivlerësimit shprehimisht ka deklaruar: “Një shtesë kati, sipërf. 113 m², në banesën e vëllait tim Sh.D. Banesa është e papërfunduar dhe ndodhet në rrugën “{***}”, {***}, Tiranë, vlera 1.700.000 lekë, 100%”.

62.3. Ka rezultuar se deklarata periodike 2007, është plotësuar nga subjekti i rivlerësimit në datën 19.06.2008, shprehimisht duke deklaruar: “Pakësimi i gjendjes *cash* të deklaruar më parë, i përdorur për ndërtimin e katit të 3-të, vlera 1.250.000 lekë, pjesa 100%”. Gjithashtu, në deklaratën periodike 2007, subjekti i rivlerësimit shprehimisht ka deklaruar: “Një shtesë kati me sipërfaqe 113 m² në banesën e vëllait tim Sh.D. Banesa është e papërfunduar dhe ndodhet në rrugën “{***}”, {***}, Tiranë”.

62.4. Nga procesverbali i konstatimit të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Tiranë, datë 09.11.2010²³², i dërguar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 12.01.2018, shprehimisht rezulton se: “Për objektin banesë, të deklaruar nga Arben M. Dollapaj, me vetëdeklarimin me nr. {***} prot., datë 11.11.2006, rr. “{***}”, nga konstatimi rezulton se [...] sipërfaqja shtesë shfrytëzohet: për banim 128,43 m² të ndarë në kate [...]”. Gjithashtu, nga akt ekspertiza për objektin shtesë kati, rruga “{***}”, {***}, Tiranë, shkurt 2011, e ing. A.V., te pjesa e përshkrimit të objektit, shprehimisht citohet: “Objekti është i përbërë nga 2 kate, të cilat janë shtëpi banimi”, dhe se: “Verifikimi dhe matjet faktike u kryen sot më datë 19.02.2011”²³³.

²³⁰ Shih formularin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale {***}, datë 16.02.2011, të ALUIZN-it, për shtesë kati, me subjekt posedues z. Arben Dollapaj, për vetëdeklarimin e datës 11.11.2006.

²³¹ Adresa e objektit: “Rruga “{***}” (“{***}”), {***}, Tiranë”.

²³² Shih f. 596-597 të dosjes së Komisionit.

²³³ Shih f. 630 të dosjes së Komisionit.

62.5. Subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e poseduesit të ndërtimit, për objektin shtesë kati, nëpërmjet formularit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale, me nr. indeksi {***}, datë 16.02.2011, rezulton të ketë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë për investimin e kryer në vlerën 3.638.807,19 lekë.

62.6. Sipas kontratës së kredisë bankare me {***}-në nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.05.2011, rezulton se kredimarrësit Arben Dollapaj²³⁴ i është akorduar një total kreditimi prej 5.000.000 lekësh, bazuar në K.Civil, në ligjin nr. 9232/2004, në vendimin e KM-së nr. 600/2007, në udhëzimin nr. 6257, datë 02.09.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave nr. 10240/1, datë 17.10.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, në “Marrëveshjen Tripalëshe”, datë 18.02.2009, si dhe çdo marrëveshje tjetër nënshkruar mes palëve në lidhje me këtë objekt, me qëllim për blerje shtëpie.

62.7. Nga vërtetimi nr. {***} prot., datë 12.01.2017, i {***}-së dhe nxjerrja e llogarisë së {***}-së nr. {***}, të z. Arben Dollapaj, rezulton se kredia është disbursuar në shumën 4.950.000,00 lekë, në datën 26.05.2011, dhe kjo shumë është xhiruar në favor të z. Sh.D.

63. Të vlerësuara në tërësi sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj, me cilësinë e investitorit, kishte filluar ndërtimin në vitin 2006, ndërtim i cili, sipas konstatimit të ALUIZNI-t, kishte qenë banesë e shfrytëzueshme në datën 09.11.2010, dhe se vlera përfundimtare e investimit të filluar në vitin 2006, në momentin e legalizimit nga ALUIZNI, sipas lejes nr. {***}, datë 11.07.2012, kishte arritur vlerën prej 3.638.807,19 lekë. Nga ana tjetër, kredia me kushte lehtësuese rezulton të jetë marrë në datën 18.05.2011, ose e thënë ndryshe mbi 6 muaj pasi ALUIZNI e kishte vlerësuar shtesën e katit të shfrytëzueshme për banesë.
64. Për sa më sipër u arsyetua, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting*, në mënyrë të saktë, të plotë dhe të mjaftueshme, shtesën në katin e tretë në këtë shtëpi dhe nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie, sipas nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe për çmimin e blerjes, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.03.2011, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme dhe deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të Aneksit të Kushtetutës, neni D, pikat 1, 3, dhe 5.

64.1. Subjekti i rivlerësimit kërkoi që në analizën e tij, trupi gjykues të merrte parasysh jurisprudencën e GjEDNj-së, e konkretisht, çfarë është vendosur në çështjen *Volkov k. Ukrainës* dhe *Dimitrov k. Bullgarisë* në paragrafët 137 dhe 47, respektivisht²³⁵. Trupi gjykues vëren se përkundër sa gjeti GjEDNj-ja në çështjen *Volkov k. Ukrainës* lidhur me kufizimin në kohë të procedimit të shkeljeve disiplinore në zbatim të parimit të sigurisë ligjore, ndër të tjera, meqenëse ngjarjet për të cilat kërkuesi u shkarkua kishin ndodhur kohë më parë dhe ligji vendas nuk parashikonte parashkrim, në rastin e shkarkimit si masë disiplinore për efekt të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, natyra e shkeljeve në formën e deklarimit të paplotë, fshehjes, deklarimit të remë apo mungesës së burimeve të ligjshme, nuk përngjan me shkeljet disiplinore të zakonshme/tipike, të cilat lidhen me kryerjen e detyrës së gjyqtarit, siç ishte rasti i *Volkov*.

64.2. Më konkretisht, ndërsa shkeljet disiplinore tipike, të cilat parashikohen nga Kodi i Etikës Gjyqësore, kanë të bëjnë me ngjarje faktike të një momenti, incidentale, të plota në

²³⁴ Me dorëzanës znj. E.D. dhe z. Sh.D.

²³⁵ Shih paragrafin 34 më sipër.

momentin e kryerjes, shkeljet që lidhen me detyrimin e deklarimit të pasurive janë me natyrë të vazhduar në kohë dhe krijojnë efekte të pandërprera. Janë të vazhduara në kohë, sepse deklarimi pasuror prej subjekteve kryhet së pari përpara fillimit të detyrës dhe vazhdon rregullisht çdo vit. Bazuar në deklaratën e parafillimit të detyrës, ligji kërkon pasqyrimin vetëm të ndryshimeve, shtim dhe pakësim, dhe jo deklarim nga e para. Sipas ligjit nr. 9049/2003²³⁶, deklaratat periodike të interesave privatë janë dokumente zyrtare që plotësohen periodikisht, me vullnet dhe ndërgjegje të plotë nga subjektet deklaruuese dhe, për pasojë, sjellin përgjegjësi për vërtetësi për zyrtarin/subjektet e rivlerësimit, në të kundërt deklarata është e rreme. Procesi i deklarimit, po sipas së njëjtës bazë ligjore, është nga natyra i vazhdueshëm dhe i përbërë nga hallka të një zinxhiri, pasuria e krijuar në vitet paraardhëse shërben si burim krijimi për pasurinë në vitet pasardhëse. Kjo është veçanërisht me rëndësi për dinamikën që përbëhet nga deklarata para fillimit të detyrës, që shoqërohet më pas vetëm me detyrimin për pasqyrimin e shtesave dhe pakësimeve ndër vite. Për këtë arsye, deklaratat e pasurisë dhe kontrolli i interesave nuk janë dokumente të izoluara, por pjesë e një zinxhiri/procesi të rregullt që, siç përcaktohet në ligj, ka për qëllim të monitorojë deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta²³⁷.

64.3. Si shembull, pasuria e pambuluar me burime të ligjshme në njërën nga deklaratat periodike vjetore, mbetet e tillë për gjithë periudhën deklaruuese për një subjekt, deri në vitin 2016. Me fjalë të tjera, kalimi i viteve nuk ka asnjë efekt shues, pasuria e deklaruar pasaktësisht apo burimet e ligjshme të munguara mbeten në thelb me të njëjtat probleme si edhe në fillim. Nëse një subjekt blen pasuri në vitin 2011 apo 2012 me të ardhura të cilat nuk mbulohen nga burime të ligjshme që rrjedhin nga viti 2003 apo 2004, pasuritë mbeten të krijuara me burime të paligjshme, pavarësisht nga kalimi i kohës. Mungesa e burimit të ligjshëm qëndron. Si pasojë, edhe deklarimi i paplotë dhe i pasaktë përbëjnë veprime që nga natyra janë të vazhdueshme, mbi të cilat parashkrimi ligjor dhe tipik i shkeljeve të tjera disiplinore nuk gjen zbatim.

C. Denoncimet e publikut

- 65.** Pas verifikimit të denoncimeve të z. F.B., të znj. B.A., të znj. B.U., të z. T.D., të z. P.N., të z. R.P. dhe të z. V.Ç., Kolegji nuk konstatoi se ato nuk përmbanin indicie për faktet ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj.
- 66.** Kolegji, për denoncimin e z. S.P., iu drejtua me kërkesën për informacion me shkrim SPAK-ut, pas pretendimit të Komisionerit, i cili parashtroi se ishte në pamundësi për të mbledhur qoftë dhe indicie në lidhje me këtë denoncim, por që në dukje, sipas Komisionerit, ky denoncim përmbante të dhëna që mund të verifikoheshin pranë prokurorisë përkatëse, në rast se ishin të vërteta apo të rreme²³⁸.

66.1. Me anë të shkresës kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 14.02.2020, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) informoi Kolegjin se në regjistrin e njoftimit të veprave penale të SPAK-ut, nuk rezultonte që në emër të z. Arben Dollapaj të kishte filluar procedim penal, apo të ishte bërë ndonjë kallëzim kundër tij. Gjithashtu, SPAK-u informoi Kolegjin se, pas verifikimit të regjistrit të veprave penale të

²³⁶ Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar.

²³⁷ Neni 1, ligji nr. 9049/2003.

²³⁸ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 14.02.2020, të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk rezultonte që në emër të z. Arben Dollapaj të kishte filluar procedim penal, apo të ishte bërë ndonjë kallëzim kundër tij.

66.2. Në këto kushte, edhe pas informacioneve të marra nga SPAK-u për denoncimin e z. S.P., u konstatua se edhe ky denoncim nuk përmbante indicie për fakte ose rrethana që mund të përbënin prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Arben Dollapaj.

67. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, bazuar në aktet e administruara në dosjen e përcjellë nga Komisioni, në aktet e depozituara në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit dhe në dokumentacionin shtesë nga institucionet shtetërore, pasi dëgjoi Komisionerin Publik dhe subjektin e rivlerësimit, vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit të Komisioneri Publik, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, Kolegji arriti në përfundimet e mëposhtme.
68. Në lidhje me shkaqet e ankimit mbi pasurinë shtëpi banimi në fshatin {***} , Tropojë, sipas kontratës “Akt marrëveshje për bashkinvestim (për rikonstruksion) dhe bashkëpronësi”, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* në mënyrë të plotë dhe të saktë vlerën e investimit të sipërfaqes ndërtimore dhe destinacionin, duke u ndodhur në kushtet e deklaratimit të paplotë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, sipas përcaktimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës. Në konkluzion, Kolegji, vlerëson se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
69. Në lidhje me pasurinë shtëpi banimi me sip. ndërtimi 113 m², në Tiranë, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting*, në mënyrë të saktë, të plotë dhe të mjaftueshme shtesën në katin e tretë në këtë shtëpi dhe nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie, sipas nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe për çmimin e blerjes, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.03.2011, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme dhe deklaratimit të pamjaftueshëm, në kuptim të Aneksit të Kushtetutës, neni D, pikat 1, 3, dhe 5. Në konkluzion, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
70. Për sa më sipër u arsyetua, Kolegji vlerëson se pas shqyrtimit të shkaqeve të ankimit për pasurinë shtëpi banimi në fshatin {***} , Tropojë dhe shtëpi banimi me sip. ndërtimi 113 m² në Tiranë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Arben Dollapaj ka kryer deklaratim të paplotë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, sipas përcaktimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe se është në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, duke i vlerësuar shkaqet për këto dy pasuri të mjaftueshme²³⁹ për të mbështetur vendimmarrjen e Kolegjit.
71. Në konkluzion të sa më sipër, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 63, datë 06.08.2018, i Komisionit duhet ndryshuar, pasi nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

²³⁹ *Shih paragrafin 53 të vendimit “H kundër Belgjikës” të GjEDNj-së.*

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 63, datë 06.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj, prokuror në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit, anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë në momentin e shpalljes së këtij vendimi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall sot, në Tiranë, më datë 12.03.2020.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATOR

Luan DACI

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi